

# MANUAL PËR GAZETARË: RAPORTIMI MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE NË SHQIPËRI





# MANUAL PËR GAZETARË: RAPORTIMI MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE NË SHQIPËRI

Tiranë, 2023

**Botuar nga:** Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri  
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri  
<http://birn.eu.com/>

**Autorë:** Lawrence Marzouk  
Mihallaq Qirjo

**Redaktor shkencor:** Alken Myftiu

**Përkthyes:** Gjergj Erebara



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

Ky manual është mbështetur financiarisht nga Qeveria Suedeze dhe Programi Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve.



# Përmbajtja

## HYRJE

TË RAPORTOSH MBI MJEDISIN

9

## KAPITULLI 1

KONCEPTET KRYESORE MJEDISORE

10

## KAPITULLI 2

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

25

2.1 Institucionet në nivelin qendror

25

2.2 Institucionet në nivelin vendor

27

## KAPITULLI 3

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR MBI MJEDISIN

30

3.1 Marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore

30

3.2 Strategjitë kombëtare për çështjet mjedisore

31

3.3 Kuadri ligjor specifik për mjedisin

33

## KAPITULLI 4

VLERËSIM I PËRMBLEDHUR MBI GJENDJEN E MJEDISIT

37

## KAPITULLI 5

BURIME TË INFORMACIONIT MJEDISOR

39

5.1 Burimet ujore

39

5.2 Pyjet dhe kullotat

43

5.3 Biodiversiteti

44

5.4 Monumentet e natyrës

46

5.5 Burimet minerare

47

5.6 Burimet energjetike

47

## **KAPITULLI 6**

### **RAPORTIMI MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE**

**50**

- |                                                                                |           |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 6.1 Ndryshimet klimatike - koncepte themelore                                  | <b>50</b> |
| 6.2 Si të merremi me skeptikët e klimës dhe verifikimi i fakteve               | <b>53</b> |
| 6.3 Si të bësh një lajm mbi ndryshimet klimatike domethënës për audiencën tuaj | <b>54</b> |

## **KAPITULLI 7**

### **MJETE PËR RAPORTIMIN MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE**

**59**

- |                                                             |           |
|-------------------------------------------------------------|-----------|
| 7.1 Pamjet ajrore                                           | <b>59</b> |
| 7.1.1 Burimet e pamjeve satelitore                          | <b>60</b> |
| 7.1.2 Inteligjenca artificiale (AI)                         | <b>66</b> |
| 7.2 Burimet ndërkombëtare të statistikave dhe të të dhënave | <b>67</b> |
| 7.2.1 Statistikat e OKB-së                                  | <b>68</b> |
| 7.2.2 Të dhënat e tregtisë në OKB                           | <b>68</b> |
| 7.2.3 Google Scholar                                        | <b>69</b> |
| 7.2.4 Kërkimet e avancuara në Google                        | <b>70</b> |

## **KAPITULLI 8**

### **KRYEJ TESTIMET E TUA**

**73**

- |                                    |           |
|------------------------------------|-----------|
| 8.1 Të numërosh dele, ose rrëqebuj | <b>75</b> |
| 8.2 Bli ose merr me qira pajisje   | <b>77</b> |
| 8.3 Gazetaria e sensorëve          | <b>78</b> |

## **KAPITULLI 9**

### **BIZNESI DHE MJEDISI**

**80**

# Shkurtime

|               |                                                                      |
|---------------|----------------------------------------------------------------------|
| <b>AEE</b>    | Agjencia e Eficencës së Energjisë                                    |
| <b>AKBN</b>   | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore                               |
| <b>AKM</b>    | Agjencia Kombëtare e Mjedisit                                        |
| <b>AKP</b>    | Agjencia Kombëtare e Pyjeve                                          |
| <b>AKUM</b>   | Agjencia Kombëtare Ujësllës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta      |
| <b>AKZM</b>   | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura                             |
| <b>AMBU</b>   | Agjencia e Menaxhimit të Baseneve Ujore                              |
| <b>BE</b>     | Bashkimi European                                                    |
| <b>DIK</b>    | Drejtoria e Inspektim Kontrollit                                     |
| <b>EMAS</b>   | Skema e Menaxhimit Eko dhe Auditimit                                 |
| <b>ICIJ</b>   | Konsosciumi Ndërkombëtar i Gazetarëve Investigativë                  |
| <b>IGJEO</b>  | Instituti i Gjeoshkencave                                            |
| <b>IKMT</b>   | Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit                     |
| <b>ISHP</b>   | Instituti i Shëndetit Publik                                         |
| <b>ISO</b>    | Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin                          |
| <b>HK</b>     | Herbari Kombëtar                                                     |
| <b>KBT</b>    | Kopshti Botanik i Tiranës                                            |
| <b>MBZHR</b>  | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural                           |
| <b>MEA</b>    | Marrëveshje Shumëpalëshe Mjedisore                                   |
| <b>MIE</b>    | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë                            |
| <b>MTM</b>    | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit                                    |
| <b>MSHMS</b>  | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale                      |
| <b>MSHN</b>   | Muzeu i Shkencave të Natyrës 'Sabiha Kasimati'                       |
| <b>NJVV</b>   | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore                                     |
| <b>OZHQ</b>   | Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm                               |
| <b>QKFF</b>   | Qendra Kërkimore e Faunës dhe Florës                                 |
| <b>RRSHTN</b> | Rregjistri i Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve              |
| <b>ShGjSh</b> | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar                                         |
| <b>UNEP</b>   | Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin                         |
| <b>VKM</b>    | Vendime të Këshillit të Ministrave                                   |
| <b>VNM</b>    | Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                                       |
| <b>VSM</b>    | Vlerësimi Strategjik Mjedisor                                        |
| <b>WCED</b>   | Komisioni Botëror i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin |



## Të raportosh mbi mjedisin

Ndryshimet klimatike konsiderohen gjerësisht të jenë kërcënimi më i madh për njerëzimin. Nëse parashikimet shkencore bëhen realitet, bota jonë do të pësojë ndryshime të paimagjinueshme përgjatë dekadave të ardhshme, të cilat, me shumë gjasa, do të shkaktojnë destabilitet, lufta dhe uri.

Gazetarët padyshim që po luajnë një rol të rëndësishëm në rënien e kambanave të alarmit për këtë dhe çështje të tjera mjedisore. Pa punën e vështirë dhe të guximshme të reporterëve, shumë kërcënime kyçe mjedisore, të tilla si keqmenaxhimi apo përdorimi me tepri i burimeve natyrore, do të mbeteshin të panjohura.

Gjithsesi, çështje të rëndësishme mjedisore vijojnë të mbeten të nënraportuara dhe, kur raportohen, shpesh marrin shumë pak vëmendje publike. Ato mundet dhe duhet të shpalosen në mënyrë më të mirë me qëllim që publiku të marrë një mesazh sa më të qartë.

Zhvillimi urban, konsumi i paqëndrueshëm, shfrytëzimi i burimeve natyrore, ndotja e trashëguar, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë dhe praktikët joefikase në menaxhimin dhe çlirimin në natyrë të mbetjeve janë të gjitha probleme me të cilat përballet Shqipëria dhe të cilat kërkojnë vëmendjen e reporterëve.

Gjatë viteve të fundit, kuadri ligjor i sektorit të mjedisit ka qenë gjithashtu në ndryshim. Qeveria ka punuar për të afruar veten me kuadrin ligjor të BE-së, janë krijuar apo janë forcuar strukturat për mbrojtjen e mjedisit në nivel qendror dhe vendor dhe janë firmosur një numër marrëveshesh dhe programesh ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

Gjithsesi, mbështetja financiare nga buxheti i shtetit për mbrojtjen e mjedisit mbetet e kufizuar dhe vuan nga mungesa e efikasitetit, gjë që sjell përfitime të pakta afatgjata në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Të gjitha këto çështje kërkojnë vëmendje të lartë të gazetarëve për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit mbi çështjet mjedisore mes publikut më të gjerë, medias dhe bashkësisë së biznesit.

Ky manual synon t'u ofrojë gazetarëve një të kuptuar më të mirë të ndryshimeve klimatike dhe sfidave aktuale mjedisore, si në termat e kuadrit ligjor, ashtu edhe mbi financimin dhe rrugën e Shqipërisë drejt harmonizimit me standardet e BE-së.

Manuali u ofron gjithashtu gazetarëve shqiptarë mjetet më të fundit praktike për investigimin dhe raportimin në këtë fushë, duke sugjeruar disa nga burimet më të vlefshme të informacionit.



Në këtë kapitull synojmë të japim një përmbledhje të terminologjisë më të përdorur në sektorin e mjedisit, duke synuar një kuptim të drejtë dhe përdorim të saktë të tyre në raportimet mediatike me tematikë mjedisore.

**AGJENDA E GJELBËR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR** është një strategji e re e rritjes ekonomike për Ballkanin Perëndimor, duke kaluar nga një model ekonomik tradicional, në një rritje të qëndrueshme, në përputhje me [Marrëveshjen e Gjelbër Europiane](#). Agjenda reflekton objektivin e BE-së për ta bërë rritjen ekonomike neutrale ndaj ndikimeve në klimë deri në vitin 2050, ndërsa rajoni është zotuar gjithashtu të arrijë neutralitetin e emetimeve të karbonit deri në vitin 2050. [Axhenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor](#) (GAWB) u miratua në Samitin e Sofjes në vitin 2020 dhe u pasua me miratimin e Planit të Veprimit në Samitin e Brdos në tetor 2021, duke synuar përafrimin e rajonit me elementët kryesorë të Marrëveshjes së Gjelbër Europiane. Shqipëria e ka përkrahur këtë nismë dhe merr pjesë aktive në proceset e saj.

**BURIME NATYRORE** janë elementet biotikë dhe jobiotikë, që përdoren ose që mund të përdoren nga njeriu për plotësimin e nevojave të tij.

Burimet natyrore përfshijnë të gjitha burimet nëntokësore si mineralet dhe lëndët fosile; dhe ato të sipërfaqes, përfshirë ato ujore dhe nënujore, tokën, pyjet dhe livadhet, energjinë diellore dhe të erës, llojet dhe ekosistemet natyrore. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore synon shfrytëzimin e këtyre burimeve në mënyrë të qëndrueshme, duke ruajtur stokun e secilit prej llojeve të burimeve.

Gjatë vitit 2023, ka nisur procesi i vlerësimit të këtyre burimeve në nivel vendor, duke i konsideruar si kapitali natyror. Synohet regjistrimi, menaxhimi dhe zhvillimi i kapitalit natyror, i pronës dhe të gjithë aseteve, të cilat përfshijnë mineralet, naftën, pyjet, kullotat, burimet ujore, burime energjetike, etj., në nivel vendor apo kombëtar, në pronësi të qeverisjes qendrore apo asaj vendore, në pronësi publike apo private. Procesi do të ndihmojë në vlerësimin e potencialit zhvillimor për çdo rajon të vendit.

**BURIME TË RIPËRTËRITSHME** janë burimet natyrore, që përtërihen në mënyrë natyrore ose që mund të përtërihen plotësisht ose pjesërisht me rrugë të tjera. Të gjitha burimet e tjera janë të papërtëritshme. Të tilla burime të ripërtëritshme janë energjia hidrike, energjia diellore, e erës, gjeotermike, e valëve, baticës dhe zbaticës, biomasës.

Shqipëria vlerësohet si vend me burime të shumta të ripërtëritshme. Vendi numëron shtatë basene ujëmbledhës të lumenjve, tre liqene të mëdhenj si dhe vijën bregdetare përgjatë detit Adriatik dhe detit Jon. Vendi ka klimë mesdhetare, me numër të lartë ditësh me diell dhe rrezatim diellor të fuqishëm, një biodiversitet të pasur të botës bimore dhe shtazore (rreth 30% të e florës europiane gjendet në territorin e vendit tonë) dhe larmishmëri të ekosistemeve natyrore që shtrihen nga bregu i detit deri në lartësinë 2700 m mbi nivelin e detit.

## BURIMET E SHKARKIMIT TË NDOTJES

**Burime pikësore** janë burime antropogjene të shkarkimeve, të cilët nga pikëpamja praktike ndodhen në pika të identifikuar në hapësirë. Termi mbulon burime të tilla si impiante të trajtimit të ujërave të zeza, impiante energjie, instalime të tjera industriale dhe ndërtesa ose prona të ngjashme me një shtrirje të vogël hapësinore.

Shembuj burimesh pikësore janë tubacione shkarkimi ujrash të zeza, pika të hedhjeve ilegale të mbetjeve të ngurta, oxhaqe shkarkimi të gazeve në atmosferë, etj. Burimet pikësore janë lehtësisht të identifikueshme dhe ato mund të monitorohen për një periudhë të kufizuar ose mund të monitorohen në vijimësi.

**Burimet e shpërndara** janë një grup burimesh të vogla, që çlirojnë ndotës në tokë, ujë dhe ajër, ndikimi i kombinuar i të cilave është i rëndësishëm në mjedisin.

Shembuj burimesh të shpërndara mund të jepen vetëm lidhur me veprimtarinë që shkakton ndotjen si për shembull ndotja e ujërave me nitrate, fosfate dhe pesticide nga bujqësia (ujërat e shiut apo të ujitjes shpëllajnë tokën, duke transferuar këto kimikate në ujërat nëntokësore dhe më pas në lumenj); ndotja e atmosferës nga mjetet e transportit rrugor, detar apo ajror (mjetet e transportit janë pika shkarkimi të ndotjes, por meqë janë në lëvizje konsiderohen si burime të shpërndara të ndotjes); etj.

**DEKLARATA MJEDISORE** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministri i Mjedisit pas shqyrtimit të kërkesës për miratimin e një projekti, plani ose programi të përcaktuar, që miraton

ose jo kërkesën, duke shoqëruar me kushte detyrues të zbatueshme për propozuesin dhe organet shtetërore përgjegjëse.

**DËMTIMI I MJEDISIT** është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, ulja e prodhimit biologjik dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve natyrore dhe të ndërtuara nga njeriu, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit, tokës prej veprimtarive njerëzore ose fatkeqësive natyrore, si dhe nga mbishfrytëzimi i burimeve natyrore dhe minerare.

Ky term është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha kategoritë e veprimtarive apo të proceseve që ulin cilësitë e mjedisit. Përdorimi i tij duhet lidhur me specifikime të mëtejshme të llojit të dëmtimit dhe shkallës së tij. Në shumë raste, në gazetarinë mjedisore, përdorimi i tij lidhet me pasojën e ndodhur nga një veprimtari i caktuar, p.sh. bumi i ndërtimeve në zonat urbane ka sjellë si pasojë dëmtimin e mjedisit në një sërë komponentësh si: përkeqësim të cilësisë së ajrit, zvogëlim të sipërfaqeve të gjelbra, etj.

**DËMTIMI HISTORIK I MJEDISIT** është ndotja me lëndë të rrezikshme dhe mbetje e zonave industriale dhe e rrethinave të tyre, e shkaktuar nga veprimtaritë e ndërmarrjeve, të cilat sot mund të jenë në gjendje pune, të mbyllura, të braktisura, të privatizuara ose të dhëna me koncesion dhe që vazhdojnë të kërcënojnë shëndetin dhe mjedisin.

Në disa zona të vendit tonë, ende trashëgojnë venddepozitime të mbetjeve minerare apo industriale të krijuara përpara viteve 1990. Në disa studime të kryera nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), në vitet 2000, ato janë përcaktuar si pika të nxehta mjedisore, që vijojnë të dëmtojnë mjedisin përmes shpëlarjes prej shirave, ndotjes së tokës në vendet ku janë depozituar, etj. Të tilla mund të përmendim të gjitha dampat minerare si: në Gurin e Kuq, Rubik apo Bulqizë. Në disa raste prania e kimikateve të rrezikshme mbetet shumë e lartë në tokën ku kanë qenë veprat industriale ose në zonën përreth tyre, ndonëse ato janë pothuaj tërësisht të shkatërruara, si në ish-Uzinën e Superfosfatit në Laç, zonën industriale në Durrës, në ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan, etj.

**EKONOMIA QARKULLUESE** është një model prodhimi dhe konsumi, i cili përfshin ndarjen, dhënien me qira, ripërdorimin, riparimin, rinovimin dhe riciklimin e materialeve dhe produkteve ekzistuese për aq kohë sa të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, zgjatet cikli i jetës së produkteve.

Në praktikë, kjo nënkupton zvogëlimin e mbetjeve në minimum. Kur një produkt arrin fundin e jetës së tij, materialet e tij mbahen brenda ekonomisë kurdo që është e mundur, falë riciklimit. Këto mund të përdoren në mënyrë produktive përsëri dhe përsëri, duke krijuar kështu vlerë të mëtejshme.

Ky model zhvillimi është i ndryshëm nga modeli tradicional, linear ekonomik, i cili bazohet në modelin merr-prodho-hidh. Modeli tradicional mbështetet në përdorimin e sasive të mëdha të lëndëve të para dhe të energjisë që gjenden lehtë dhe kushtojnë lirë. Kriza e burimeve dhe e energjisë ka nxjerrë në pah se modeli tradicional nuk është i qëndrueshëm për zhvillimin ekonomik global apo të vendeve të veçanta. Rritja e çmimit të lëndëve të para dhe të burimeve të energjisë, si dhe shtimi i mbetjeve si problem mjedisor kërkon kalimin në ekonominë qarkulluese për kursimin e lëndëve të para, të energjisë dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Nisma të tilla janë të shumta në çdo nivel. Shumë kompani ndërkombëtare kanë përshtatur ciklet e prodhimit bazuar në grumbullimin e lëndëve të riciklueshme. Në nivel vendor, shumë veprimtari prodhuese kanë krijuar marrëdhënie të afërta me konsumatorin për të mbështetur prodhimin, konsumin dhe riciklimin në distanca sa më të shkurtra.

**LEJA MJEDISORE** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, pas shqyrtimit dhe këshillimit me të gjitha palët e interesuara të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, që miraton ushtrimin e çdo veprimtarie që ka ndikim në mjedis. Në Lejen Mjedisore përcaktohen kushtet dhe rrethanat detyrues të zbatueshme, për të mos dëmtuar e ndotur mjedisin mbi normat e lejuara.

Në bazë të Lejes Mjedisore për secilin aktivitet, të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), operatorët e ndryshëm të aktivitetit ekonomik duhet të raportojnë shkarkimet e ndotjes dhe respektimin e kushteve të Lejes Mjedisore pranë AKM deri në 31 mars të vitit të ardhshëm.

Shkarkimet e ndotësve për çdo aktivitet ekonomik duhet të jenë publike në faqen e internetit të AKM-së. Gazetarët dhe çdo individ i interesuar mund të vlerësojë shkallën e ndotjes në një rajon të caktuar prej të dhënave të raportuara nga aktivitetet e pajisura me Leje Mjedisore.

**LËNDË TË RREZIKSHME** janë ato lëndë që, në bazë të vetive të tyre, përfshirë prodhimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe shkarkimin e tyre në mjedis, dëmtojnë ose mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit, florën, faunën, biocenozat dhe biotopet.

Përpunimi, përdorimi dhe hedhja në treg i lëndëve të rrezikshme kryhet sipas protokolleve të përcaktuara në dokumente ligjore të miratuara me Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

apo Urdhra specifike. Më të zakonshme ndër këto lëndë janë kimikatet si: pesticide, materiale farmaceutike, bojra dhe tretës të ndryshëm, etj. Përdorimi dhe trajtimi i tyre shoqërohet me monitorim dhe analizim të vazhdueshëm të përbërësve aktivë.

Magazinimi, transporti dhe hedhja në treg e tyre bëhet në paketime të përcaktuara sipas llojit të lëndës dhe shkallës së rrezikshmërisë. Etiketimi në gjuhën shqipe dhe përdorimi i shenjave specifike paralajmëruese mbi rrezikshmërinë është detyrim ligjor për t'u kryer sipas standardeve të përcaktuara për prodhuesin, tregtuesin, llojin e lëndës, shkallën e rrezikshmërisë, mënyrën e përdorimit, skadencën, trajtimin e mbetjeve pas përdorimit, etj.

**MARRËVESHJA E GJELBËR EUROPIANE** është një paketë nismash të politikave, e cila synon të vendosë BE-në në rrugën drejt një tranzicioni të gjelbër, me qëllimin përfundimtar të arritjes së neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Ajo mbështet transformimin e BE-së në një shoqëri të drejtë dhe të begatë me një ekonomi moderne dhe konkurruese.

Kjo marrëveshje nënvijëzon nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale në të cilën të gjitha fushat përkatëse të politikave kontribuojnë në qëllimin përfundimtar të lidhur me klimën. Paketa përfshin nisma që mbulojnë klimën, mjedisin, energjinë, transportin, industrinë, bujqësinë dhe financat e qëndrueshme – të gjitha këto janë të ndërlidhura fort me njëra-tjetrën.

Marrëveshja e Gjelbër Europiane u lançua nga Komisioni Evropian në dhjetor 2019.

**MBETJE** janë lëndët, materialet, objektet ose pjesë të tyre, të cilat nuk përdoren më ose që pronari do t'i largojë, ose detyrohet nga autoriteti përgjegjës për t'i larguar. Mbetjet vlerësohen si të tilla, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihet në procesin e prodhimit.

Në përdorimin e zakonshëm termi *mbetje* zëvendësohet nga *mbeturinë*, sidomos në rastin e përdorimit për mbetjet shtëpiake dhe urbane. Ndërmjet dy termave ka një dallim sepse mbetje konsiderohen të gjitha ato materiale që dalin prej përdorimit, por që ende kanë vlerë ekonomike nëse riciklohen duke u futur një cikël të ri prodhimi. Ndërsa mbeturinat nuk kanë vlerë ekonomike dhe dërgohen për trajtim në impiantet fundore të trajtimit (landfille për t'u depozituar ose inceneratorë për t'u djegur). Në fakt, një pjesë e mirë e mbetjeve të hedhura kthehen në mbeturinë sepse ndoten dhe nuk mund të riciklohen, si p.sh. letra apo kartoni.

**MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE** është tërësia e veprimtarive që lidhen me mbetjet, me parandalimin, grumbullimin, transportin, riciklimin dhe asgjësimin e tyre, mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtijshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me mbetjet në cilësinë e agentëve tregtarë. Menaxhimi i IntegrUAR i Mbetjeve përfshin tërësinë e masave për ndarjen e mbetjeve në burim dhe riciklimin e rrymave të mbetjeve për të zvogëluar sa më shumë sasinë e mbetjeve që shkojnë në impiantet fundore të përpunimit. Ai kryhet mbi bazën e planeve vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe planeve rajonale për transferimin dhe përpunimin e mbetjeve.

**MBETJE TË RREZIKSHME** janë mbeturinat toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të ndezshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja negative për shëndetin e njeriut dhe për ekosistemet natyrore.

Trajtimi fundor i mbetjeve të rrezikshme kryhet në qendra të specializuara përmes përpunimit kimik ose djegies në kushte të kontrolluara. Sasitë e lëndëve të rrezikshme inventarizohen prej çdo njësie përgjegjëse, ndërsa mbetjet e rrezikshme të grumbulluara dhe të përpunuara raportohen prej Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në Raportin Vjetor të Gjendjes së Mjedisit që botohet në faqen e internetit të kësaj agjencie.

Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme është i kushtueshëm dhe zgjidhjet planifikohen në nivel rajonal apo edhe kombëtar, si p.sh., trajtimi i mbetjeve spitalore, i vajrave të përdorur apo i baterive. Për disa lloje të mbetjeve të rrezikshme, përpunimi fundor i tyre bëhet vetëm në impiantet të specializuara jashtë vendit. Mbetjet e rrezikshme, të cilat, për shkak të mungesës së teknologjisë përpunuese apo të sasisë së vogël, nuk mund të përpunohen, duhen magazinuar në mënyrë të sigurtë dhe duhen monitoruar në vijimësi.

**MBROJTJA E MJEDISIT** është veprimtaria që synon parandalimin dhe kufizimin e ndotjes, të degradimit të mjedisit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

Dëmtimi i mjedisit ndodh prej dy veprimtarive bazë: ndotjes që është shkarkimi ose lëshimi në mjedis i lëndëve të ndryshme, rrezatimeve ose organizmave të gjallë, që kanë ndikim negativ mbi mjedisin, dhe degradimit apo shkatërrimit të mjedisit përmes veprimtarive shfrytëzuese dhe transformuese të cilat dëmtojnë funksionimin, vlerat dhe vetitë natyrore të tij.

**MJEDIS** është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë (të gjallë) dhe jobiotikë (jo të gjallë) që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në Tokë, duke përfshirë mjedisin natyror, ajrin, tokën, ujërat, apo larminë e ekosistemeve biologjike. Ai është kusht përcaktues për mirëqenien dhe shëndetin e njeriut, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore.

Në shqip shpesh përdoret dhe zëvendësohet gabimisht me “*ambient*”, i cili në terminologjinë teknike profesionale nënkupton “një mjedis të mbyllur pune, shkollimi, shërbimesh”.

Në një përdorim të përgjithshëm, mund të përdoren terma *mjedis natyror* referuar një pylli, livadhi, apo çdo peizazhi ku nuk ka veprime ndërhyrëse dhe transformuese nga njeriu, dhe *mjedis urban* referuar sipërfaqeve urbane me dendësi të lartë popullsie dhe shkallë të lartë transformimi.

**MONITORIMI I MJEDISIT** është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i të dhënave mjedisore me anë të vëzhgimit, të vazhduar ose periodik, të një grupi treguesish mjedisorë, cilësorë dhe sasiorë, të cilët karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrorë dhe njerëzorë.

Monitorimi i mjedisit është detyrë funksionale e agjencive qendrore që merren me menaxhimin e mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, strukturë institucionale në varësi të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin, është institucioni më i lartë përgjegjës për monitorimin mjedisor, hartimin e planeve të monitorimit, kryerjen e monitorimit dhe botimin e të dhënave të monitorimit në raportin vjetor të gjendjes së mjedisit. Përveç saj edhe agjencitë e tjera, të cilat kanë përgjegjësi për menaxhimin e burimeve natyrore, si ujërat, tokën, ajrin apo biodiversitetin, kanë detyrë funksionale monitorimin e treguesve përkatës mjedisorë dhe raportimin e të dhënave të grumbulluara. Në nivelin vendor, bashkitë kanë përgjegjësi të monitorojnë treguesit mjedisorë për të cilat kanë funksion të decentralizuar si: grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, sipërfaqet e gjelbra, etj.

**NDIKIMI NDËRKUFITAR NË MJEDIS** është çdo ndikim në një zonë, që ndodhet në juridiksionin e një vendi, nga veprimtari apo veprimtaritë që zhvillohen plotësisht ose pjesërisht në një zonë në juridiksionin e një vendi tjetër, ku nuk përfshihen dukuritë e ndikimit në mjedisin global (ndryshimet klimatike, ujërat ndërkombëtare, biodiversiteti, toka).

Vendi ynë ndan me vendet fqinj disa liqene (Liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës) dhe lumenjtë (Drin, Bunë e Vjosë). Çdo ndërhyrje në këto trupa ujorë me ndikim rajonal ndërkufitar duhet shoqëruar me procese komunikimi dhe informimi ndërmjet vendeve, sipas detyrimeve prej disa Konventave Ndërkombëtare Mjedisore (Konventa për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë

të largët, Konventa e Arhusit, etj.). Planifikimi i veprimtarive me ndikim ndërkufitar duhet të përfshijë edhe proceset e pjesëmarrjes së publikut në vendet e ndikuara.

**NDRYSHIMET KLIMATIKE** i referohen ndryshimeve afatgjata të temperaturave dhe modeleve të motit. Këto ndryshime mund të jenë të natyrshme, por që nga vitet 1850, aktiviteti njerëzor kanë qenë shtytësi kryesor i ndryshimeve klimatike, kryesisht për shkak të djegies së lëndëve djegëse fosile (si qymyri, nafta dhe gazi), të cilat prodhojnë gazra që kapin nxehtësinë, të ashtuquajtura gaze serë.

Në dallim nga ndryshimet klimatike ciklike që kanë ndodhur në epokat gjeologjike të Tokës, këto të fundit kanë një ritëm të rritjes së temperaturës mjaft më të lartë. Rritja e temperaturës me 1°C në të shkuarën ka ndodhur përgjatë 100.000 vjetëve, dhe i ka lejuar botës së gjallë mundësinë e përshtatjes apo të zhvendosjes në rajone të tjera, ndërkohë ndryshimet klimatike që po përjetojmë, ku temperatura është rritur me 1,2°C, kanë ndodhur në më pak se 150 vjet.

Gazet kryesore serë që po shkaktojnë ndryshimet klimatike, përfshijnë dioksidin e karbonit dhe metanin. Këto vijnë nga përdorimi i lëndëve fosile (naftës, gazit natyror dhe qymyr gurit) si lëndë energjetike në transport dhe industri. Ndryshimet në përdorimin e tokës si betonizimi dhe prerja e pyjeve rrisin sasinë e gazeve serë në atmosferë. Energjia, industria, transporti, ndërtesat, bujqësia dhe përdorimi i tokës janë ndër sektorët kryesorë që shkaktojnë gazrat serë. Shtimi i blegtorisë për prodhimin e mishit dhe produkteve të tjera blegtorale ka rritur sasinë e gazit metan.

Pasojat e ndryshimeve klimatike vërehen në ndryshimet e temperaturës (valët e të nxehtit dhe të ftohtit) dhe prishja e regjimit të reshjeve (periudha të gjata thatësire, rrebeshe dhe stuhi me intensitet më të lartë). Këto ndryshime sjellin pasoja mbi ekosistemet natyrore, aktivitetin ekonomik dhe shëndetin e njerëzve (zjarre, përmbajtje, përhapje të sëmundjeve, zvogëlim të prodhimit bujqësor, zhvendosje të popullsisë, etj.).

Shtatë vendet me shkarkimet më të mëdha (Kina, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, India, Bashkimi Europian, Indonezia, Federata Ruse dhe Brazili) përbënin rreth gjysmën e të gjitha shkarkimeve globale të gazeve serë në vitin 2020.

Mijëra shkencëtarë dhe përfaqësues të qeverive kanë rënë dakord se kufizimi i rritjes së temperaturës globale në jo më shumë se 1,5°C do të na ndihmonte të shmangnim ndikimet më të këqija klimatike dhe të ruanim një klimë të jetueshme. Megjithatë, politikat aktuale parashikojnë një rritje të temperaturës me 2,8°C deri në fund të shekullit. Marrëveshjet globale që synojnë përmbytjen e këtij qëllimi për klimën janë [Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), [Konventa Kuadër e OKB-së për Ndryshimet Klimatike](#) dhe [Marrëveshja e Parisit](#). Ato synojnë tre drejtime për veprim: uljen e shkarkimeve të gazeve serë, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe financimin e zhvillimit të gjelbër që mbron klimën.



Kalimi nga lëndët djegëse fosile tek burime të rinovueshme, si dielli ose era, për prodhimin e energjisë, do të zvogëlojë shkarkimet që shkaktojnë pasoja në ndryshimin e klimës. Një numër në rritje vendesh, përfshirë edhe Shqipërinë, po angazhohen për shkarkime neto zero deri në vitin 2050, ndërkohë që këto shkarkime duhet të përgjysmohen deri në vitin 2030 për të mbajtur ngrohjen globale nën 1,5°C.

**NDOTJA E MJEDISIT** është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmës dhe faktorëve biologjikë në ajër, në ujë e në tokë, të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës.

Kategoritë e ndotjes mund të përcaktohen nga lloji i ndotjes apo aktiviteti që i shkakton. Sipas llojit të ndotjes kemi:

*Ndotje fizike:* pluhurat, rrezatimet, ndotja nga zhurmat, nxehtësia, etj.

*Ndotje kimike:* ndotje nga kimikatet, pesticidet, shkarkimet e gazrave në atmosferë, etj.

*Ndotje biologjike:* ndotje bakteriale nga bakteri i fekaleve në ujë *E. coli*, llojet aliene si gaforja blu në lagunat e bregdetit shqiptar, organizmat e modifikuara gjenetikisht, etj.

Sipas aktivitetit shkaktues të ndotjes kemi: ndotje industriale, ndotje nga transporti, ndotje nga bujqësia, etj. Duhet patur parasysh se një aktivitet mund të shkaktojë disa lloje ndotjesh njëkohësisht si ndotje fizike p.sh. lëshimi i pluhurave në ajër, dhe zhurmave në mjedis, ndotje kimike si çlirimi i gazrave, etj.

Duhet pasur parasysh se ndotja është gjithnjë produkt i aktivitetit njerëzor. Nëse si rezultat i erozionit natyror apo shpërthimit të një vullkani rritet përmbajtja e sedimenteve në ujë ose e pluhurave dhe gazrave në ajër, ky proces nuk duhet klasifikuar si ndotje e komponentëve të mjedisit.

**NORMA E SHKARKIMEVE NË MJEDIS** është vlera më e madhe e lejuar e përmbajtjes së lëndëve ndotëse në shkarkimet për një periudhë kohore të dhënë. Normat e shkarkimeve zbatohen në pikat ku shkarkimet dalin nga instalimi pa u holluar.

## PARIMET E MBROJTJES DHE KUJDESIT NDAJ MJEDISIT

**Parimi i “Kujdesit”** është marrja e vendimeve dhe e veprimeve të nevojshme për të pakësuar rrezikun mjedisor, për të parandaluar dhe pakësuar në kohën e duhur çdo dëmtim të ardhshëm të mjedisit.

**Parimi i “Parandalimit”** është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikime të dëmshme të një veprimtarie në mjedis.

**Parimi i “Riaftësimit”** është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vetë personat fizikë e juridikë që i shkaktojnë dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar.

**Parimi “Ndotësi paguan”** nënkupton se ndotësi ka detyrimin për të paguar kostot për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen.

Këto parime janë të sanksionuara në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit. Njohja e tyre përbën bazën për njohjen e detyrimeve ligjore për shkaktuesin e dëmit mjedisor. Si shembull mund të përmendet Përgjegjësia e Zgjervuar e Prodhuesit, që nënkupton detyrimin që kanë prodhuesit për të grumbulluar dhe ricikluar paketimet dhe ambalazhet që hedhin në treg dhe krijojnë mbetje.

**SISTEMI I ADMINISTRIMIT MJEDISOR** përmbledh kuadrin institucional, politikat, planet e veprimit dhe masat tekniko-administrative për mbrojtjen e mjedisit, i certifikuar nga organizmat ndërkombëtare ISO dhe EMAS.

**ISO 14001** është një standard ndërkombëtar i [Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin](#) (ISO), i cili përcakton kriteret për sistemin e menaxhimit mjedisor dhe që mund të certifikohet. Ai përshkruan një kornizë që një kompani ose organizatë mund të ndjekë për të ngritur një sistem efektiv të menaxhimit mjedisor. I projektuar për çdo lloj organizate, pavarësisht nga aktiviteti apo sektori i saj, ai mund të ofrojë siguri për stafin menaxhues dhe punonjësit e kompanisë, si dhe palët e interesuara se ndikimi mjedisor i aktivitetit të organizatës matet dhe se ka masa të planifikuara për menaxhimin e ndikimit. Kriteret për të përmbushur këtë standard mjedisor lidhen me auditimin, komunikimin, etiketimin dhe analizën e ciklit jetësor dhe masat për të adresuar sfidat mjedisore, të tilla si ndryshimet klimatike. Kjo familje standardesh përfshin disa standarde specifike si ISO 14020 - Standardi i Eko-etiketimit, ISO 14040 - Standardi për Vlerësimin e Ciklit të Jetës, etj.

**Skema e Menaxhimit Eko dhe Auditimit (EMAS)** është [një mjet](#) krijuar

nga Komisioni Evropian përmes një Rregulloreje të posaçme, që synon të ndihmojë organizatat të përmirësojnë performancën e tyre mjedisore, të kursejnë energji dhe të optimizojnë përdorimin e burimeve. Është një instrument menaxhimi për të vlerësuar, raportuar dhe përmirësuar performancën mjedisore të organizatave, i detyrueshëm për vendet anëtare të BE-së.

**TEKNIKAT MË TË MIRA TË MUNDSHME** përfaqësojnë fazën më të përparuar të zhvillimit të veprimtarive me nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, dhe që janë plotësisht të zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.

Zakonisht ky term përdoret në rastet e aplikimit të teknologjive dhe praktikave me qëllim për të zvogëluar sa më shumë ndikimin negativ të ndërhyrjes në mjedis. Shembuj tipikë të teknologjive më të mira të mundshme janë rastet e përdorimit të teknologjive të përpunimit të burimeve natyrore apo mbetjeve, që synojnë zvogëlimin e shkarkimeve dhe monitorimit të tyre, apo të praktikave të luftimit të llojeve dëmtuese të kulturave bujqësore, përdorimi i këtyre teknikave nënkupton planifikimin, blerjen dhe përdorimin e teknologjisë më pak ndotëse dhe më eficiente në raport me sasinë e burimeve natyrore që konsumon si energji, ujë ose lëndë të tjera të para. Në anglisht termi njihet me shkurtesën BAT (Best Available Technique/Technology).

**TRANSFERIM I NDOTËSVE** është lëvizja e ndotësve jashtë vendit të prodhimit ose vendit ku mbahen, e kryer për përdorim, ripërdorim, magazinim, përpunim, rifitim energjie, riciklim ose depozitim.

Bazuar në Protokollin e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve (në anglisht PRTR) operatorët industrialë duhet të bëjnë vetë raportimin vjetor të shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve sipas kushteve të përcaktuara në Lejen Mjedisore pranë AKM-së. Ky detyrim duhet të shtrihet tek të gjithë aktivitetet që shkarkojnë mbetje përfshirë serat bujqësore, impiantet blegtorale, minierat dhe guroret, inceneratorët, etj.

**TREGUESI MJEDISOR** është një ndryshore që jep në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtë të dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bërë atë të perceptueshme nëpërmjet dhënies së një vlere numerike, matjes dhe komunikimit. Dukuritë mjedisore lidhen me cilësitë e mjedisit e të përbërësve të tij, shkarkimet në mjedis, ndotjen e mjedisit e dëmtimin e tij, biodiversitetin dhe shkallën e dëmtimit ose të ruajtjes së tij dhe masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

Treguesit mjedisor janë specifike për çdo komponent të mjedisit dhe shërbejnë për të monitoruar cilësinë e atij komponenti mjedisor si edhe për të ndihmuar në vlerësimin e shëndetit të mjedisit. Të tillë mund të jenë përmbajtja e nitrateve dhe fosfateve në ujë (prania e lartë e tyre tregon ndotje me origjinë bujqësore), numri i shpendëve dimëruar dhe/ose folezues në një lagunë (prania e shumë llojeve dhe e numrit të lartë të popullatave për çdo lloj tregon një shkallë të lartë biodiversiteti, mungesë të shqetësimit nga aktiviteti njerëzor dhe cilësi të lartë të burimeve natyrore me të cilat ushqehen).

Treguesit mjedisorë janë parametrat që monitorohen nga institucionet sipas planeve të monitorimit të botuara në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Kategoritë e treguesve kryesore mjedisore janë të përcaktuar në dokumentet ndërkombëtare (konventa dhe protokolle mjedisorë) dhe legjislacionin europian. Për qëllime kërkimi apo monitorimi të zonave të veçanta mjedisore, institucionet mund të përcaktojnë edhe tregues mjedisorë specifike që ndihmojnë të kuptohet dhe monitorohet gjendja mjedisore në atë zonë.

**SHKARKIME NË MJEDIS** janë çlirimi dhe dalja në mjedis, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e lëndëve të gazta, të ngurta, të lëngëta, si dhe energjisë, vibracioneve e zhurmave, nga një ose disa burime të palëvizshme, të lëvizjeve ose të shpërndara.

Niveli i shkarkimeve në mjedis përcaktohet në kuadrin ligjor, përfshirë ligjet specifike mjedisore, si p.sh. në Ligjin Për Mbrojtjen e Ajrit, Ligjin Për Zhurmat, Ligjin Për Kimikatet, etj. Ndonëse në kuadër të procesit të integritetit europian të vendit është kryer edhe përafrimi i këtyre standardeve me ato të BE-së, vendet anëtarë të BE-së dhe ato candidate mund të përcaktojnë norma të shkarkimeve të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato të BE-së, sidomos në rastin e shkarkimeve më të ulëta se ato të miratuara nga kuadri ligjor europian. Normat e shkarkimit janë pjesë e politikave mjedisore dhe si të tilla rishikohen në vijimësi. Për shembull, ulja e shkarkimeve të gazeve serë është ndër proceset më dinamike të viteve të fundit për të arritur objektivat e BE-së për vitin 2030 dhe 2050.

**VEPRIMTARI ME NDIKIM NË MJEDIS** është çdo veprimtari ekonomike e shoqërore, që përdor mjedisin ose përbërës të tij ose që shkarkon në mjedis lëndë dhe energji, duke ndryshuar cilësitë e tij.

Ndonëse çdo veprimtari e njeriut ka ndikimin e saj në mjedis, kuptimi më i përgjithshëm për këtë term janë ato veprimtari që shkaktojnë ndryshime negative përmes ndotjes dhe/ose shkatërrimit të mjedisit. "Ndikimi në mjedis" është çdo ndryshim i mjedisit fizik, përfshirë pasojat shëndetësore, ekonomike, shoqërore, estetike, natyrore dhe fizike.

Për të minimizuar dhe kontrolluar ndikimet negative të këtyre veprimtarive, me Ligjin Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis përcaktohen dy kategori të lejeve mjedisore që duhen marrë përpara fillimit të çdo investimi. Lejet e tipit A përfshijnë impiante të mëdha industriale në ndikime të konsiderueshme në mjedis, ndërsa lejet e tipit B përfshijnë veprimtari që kanë ndikim më të vogël. Aplikimi për lejet mjedisore bëhet *online* në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas listave të veprimtarive dhe kapacitetit të impiantit që planifikohet të ndërtohet.

**VLERËSIMI MJEDISOR** është rivlerësimi periodik i administrimit të mjedisit dhe mbrojtjes së tij, që bëjnë personat fizikë e juridikë për instalime ose veprimtari të pajisura me leje mjedisore.

**VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)** është procesi që kryhet për të identifikuar, parashikuar, interpretuar, matur, komunikuar e parandaluar ndikimin e një projekti në mjedis, sipas disa varianteve të tij, me qëllim që të përzgjidhet varianti më i mirë për parandalimin dhe zbutjen e ndikimit negativ, para se projekti të miratohet dhe të zbatohet.

VNM është studim i cili duhet kryer nga specialistë mjedisorë të fushave ku pritet ndikimi negativ i një projekti të caktuar. Përmbajtja dhe struktura e studimit përcaktohen sipas ligjit të VNM-së. Opinioni i specialistëve duhet të jetë bllokues nëse ndikimi në mjedis është shumë i madh dhe i pakthyeshëm, mund të jetë i kushtëzuar për të gjetur dhe përshtatur alternativa të zgjidhjeve teknike që zvogëlojnë ndikimin në mjedis ose lejues nëse ndikimi në mjedis është i vogël dhe i rikuperueshëm.

Studimi i VNM-së duhet të jetë i hapur për publikun dhe të kalojë në procesin e dëgjësive dhe diskutimit publik me palët e interesuara, duke u shoqëruar edhe me një relacion lidhur me sugjerimet dhe ndryshimet e pranuar.

Studimet e VNM-së botohen dhe duhet të jenë të aksesueshme në faqen e internetit të AKM-së.

**VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)** është procesi i vlerësimit të ndikimeve të mundshme në mjedis të një politike, plani dhe programi.

Ky lloj studimi është mjaft i rëndësishëm për të planifikuar zhvillimin e një rajoni të caktuar. Ai merr në konsideratë efektin kumulativ të ndotjes dhe dëmtimit mjedisor nga zhvillimi i zonës dhe në bazë të këtij vlerësimi, vendos kufij në zhvillimin e zonës (për qëllime urbane, industriale apo shërbimesh), të cilat respektojnë standartet mjedisore dhe ruajnë ekuilibrin mes aktiviteteve

zhvilluese dhe cilësisë së mjedisit në atë zonë.

Studimi i VSM-së duhet të jetë i hapur për publikun dhe të kalojë në procesin e dëgjësive dhe diskutimit publik me palët e interesuara, duke u shoqëruar edhe me një relacion lidhur me sugjerimet dhe ndryshimet e pranuar.

Studimet e VSM-së botohen dhe duhet të jenë të aksesueshme në faqen e internetit të AKM-së dhe agjencive të tjera përgjegjëse për studimin.

**ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM** është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre. Zhvillimi i Qëndrueshëm bazohet në tre fusha të ndërlidhura ndërmjet tyre:

**Qëndrueshmëria sociale:** Rritja e popullsisë duhet të korrespondojë me normat e ripërtëritjes së burimeve natyrore dhe duhet të bazohet në bashkëpërgjegjësi në shpërndarjen e pasurisë. Kjo nënkupton rritjen e popullsisë në përputhje me kapacitetin mjedisor dhe çrrënjosjen e varfërisë.

**Qëndrueshmëria ekonomike:** rritja ekonomike duhet të respektojë mjedisin, domethënë nuk duhet të kalojë kapacitetin rigjenerues të burimeve natyrore. Po kështu, duhet t'i përkushtohet barazisë shoqërore në shpërndarjen e burimeve

**Qëndrueshmëria mjedisore:** i referohet sigurisë dhe ruajtjes së burimeve natyrore edhe për brezat e ardhshëm. Qëndrueshmëria mjedisore kërkon të garantojë kushte që shoqëria të mbështesë vetveten dhe, për këtë arsye, kërkon të garantojë qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike.

Në vitin 1987, Komisioni Botëror i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (WCED) prezantoi Raportin Brundtland, të emërtuar sipas presidentit të këtij Komisioni, dr. Gro Harlem Brundtland. Sipas raportit, zhvillimi i qëndrueshëm përkufizohet si: "Plotësimi i nevojave të brezave të tanishëm, pa kompromentuar mundësitë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre."

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u bë fokusi i konferencave të mëvonshme ndërkombëtare mbi mjedisin dhe zhvillimin ekonomik, të tilla si:

- Rio de Zhaneiro, 1992: Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, e cila rezultoi në Deklaratën e Rios.
- Nju Jork, 1997: Samiti i Tokës +5.
- Johanesburg, 2002: Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, i njohur gjithashtu si

Rio +10.

- Rio de Janeiro, 2012: Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e njohur si Rio +20.
- Nju Jork, 2015: Samiti i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm, dokumenti përfundimtar i të cilit ishte "Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm".

## KAPITULLI 2

# INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Më poshtë në këtë kapitull renditen autoritet kryesore publike në nivel qendror dhe lokal që luajnë një rol në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe praktikave që kanë ndikim në mjedis.

### 2.1 Institucionet në nivelin qendror

Në strukturën e qeverisë shqiptare janë disa ministri që kanë përgjegjësi në lidhje me mjedisin.

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)** ([www.turizmi.gov.al](http://www.turizmi.gov.al)) me organet dhe strukturat e veta, organet mjedisore në institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, si dhe çdo organ qendror dhe vendor që krijohet në vijim të tyre.

Funksionet e saj përfshijnë rregullimin dhe administrimin në lidhje me mjedisin, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, promovimin e burimeve të rinovueshme, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pylltarisë dhe kullotave, dhe monitorimin cilësor të burimeve ujore.

Në varësi të kësaj Ministrie janë disa agjenci si:

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura**, (AKZM) ([www.akzm.gov.al](http://www.akzm.gov.al)), institucioni qendror shtetëror përgjegjës për Zonat e Mbrojtura, i cili ka për detyrë administrimin dhe kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKZM ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas administratave rajonale të Zonave të Mbrojtura.

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)**, ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)) ka funksion të sigurojë performancën mjedisore; të bëjë kërkime dhe monitorim mjedisor; të bëjë vlerësimin e ndikimit në mjedis, të licencojë veprimtaritë ekonomike me ndikim në mjedis, si dhe të inspektojë dhe të kontrollojë respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore. Në strukturën e kësaj Agjencie përfshihet edhe Drejtoria e Inspektim Kontrollit (DIK) (<https://akm.gov.al/inspektim-kontrolli/>), që ka si funksion të saj monitorimin dhe inspektimin mjedisor të territorit. DIK përbëhet nga katër sektorë, ndër të cilët edhe sektori i inspektimit mjedisor dhe sektori i inspektimit të burimeve natyrore. Në faqen e saj të internetit botohen përmbledhje dhe të dhëna rreth numrit të inspektimeve, gjobave dhe ankimeve të kryera në periudha të caktuara kohore.



**Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP)** ([www.akpyje.gov.al](http://www.akpyje.gov.al)) ka detyrë mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre si dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar. Ajo ka rolin e një autoriteti që garanton performancën dhe efikasitetin e sektorit, siguron standarde dhe metodologji për aktivitetet dhe operacionet e sektorit, krijon një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e informacionit dhe garantimin e performancës dhe standardeve në lidhje me fondin pyjor kombëtar.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)** ([www.infrastruktura.gov.al](http://www.infrastruktura.gov.al)), së bashku me agjencitë në varësi të saj ka një varg përgjegjësish kryesisht të lidhura me energjitë e rinovueshme, efencën e energjisë, klimën dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Në varësi të kësaj Ministrie janë:

**Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)** ([www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)) ka detyrë zhvillimin, mbikqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, si dhe monitorimin gjatë dhe pas shfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

**Agjencia e Eficencës së Energjisë (AEE)** ([www.eficenca.gov.al](http://www.eficenca.gov.al)) ka detyrë zbatimin e masave dhe politikave që kanë për qëllim nxitjen e shfrytëzimit me efencë të energjisë, kryerjen e auditimeve energjetike dhe promovimin e energjive të rinovueshme.

**Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM)** ([www.akum.gov.al](http://www.akum.gov.al)) ka detyrë të koordinojë dhe monitorojë aktivitetin për sigurimin e furnizimit me ujë, kanalizimet e ujërave të përdorura dhe trajtimin e tyre, infrastrukturën për trajtimin fundor të menaxhimit të mbetjeve për të gjithë popullsinë e vendit, në bashkëpunim me pushtetet vendore dhe subjektet e menaxhimit të infrastrukturës ujore dhe menaxhimit të mbetjeve.

Edhe ministri të tjera kanë përgjegjësi specifike, si p.sh., Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka përgjegjësi për menaxhimin e kimikateve të lidhura me bujqësinë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) ka përgjegjësi për menaxhimin e mbetjeve spitalore, etj.

Agjenci të tjera me përgjegjësi të rëndësishme në grumbullimin e informacionit mjedisor, përmes monitorimit dhe programeve studimore, janë:

**Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)** ([www.ishp.gov.al](http://www.ishp.gov.al)), strukturë në varësi të MSHMS, monitoron një sërë treguesish të shëndetit mjedisor të lidhur me cilësinë e ujërave, trajtimin të mbetjeve, ajrit, mjedisit të punës, etj.

**Agjencia e Menaxhimit të Baseneve Ujore (AMBU)** ([www.ambu.gov.al](http://www.ambu.gov.al)), strukturë nën zyrën e Kryeministrit, harton planet e menaxhimit të baseneve ujore. Ajo harton dhe zbaton politika, strategji, plane, programe dhe projekte, që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiorë dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre; zbaton dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për burimet ujore dhe ato ndërkufitare; ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit; i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien me koncesion të burimeve ujore, si dhe bën dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit dhe shkarkimeve, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm; harton inventarin kombëtar të burimeve ujore.

**Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO)** ([www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)), është institut kërkimor në varësi të Universitetit Politeknik të Tiranës; ai monitoron dhe vlerëson rreziqet natyrore si tërmetet, stuhitë, ortekët, përmbytjet, thatësitë, zjarret, tektonikën aktive, rrëshqitjet masive të shpateve kodrinore dhe malore, erozionin e tokës.

**Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh)** ([www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al)), është institucion publik këshillimor, teknik dhe shkencor që kryen studime mjedisore të karakterit gjeologjik dhe hidrologjik lidhur burimet natyrore të mineraleve, hidrokarbureve, ujërave nëntokësore, etj.

**Qendra Kërkimore e Faunës dhe Florës (QKFF)** (<https://fshn.edu.al/Departments/qendra-kerkimore-e-flores-dhe-faunes/>), njësi e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, administron dhe pasuron vazhdimisht koleksionet shkencore të florës dhe faunës shqiptare në institucione të tilla si Muzeu i Shkencave të Natyrës 'Sabiha Kasimati' (MShN), Kopshti Botanik i Tiranës (KBT), dhe Herbari Kombëtar (HK), si dhe monitoron dhe dokumenton larminë bimë dhe shtazore të Shqipërisë.

Në rastet e ndërhyrjes në territor dhe kryerjes së veprimtarive të paligjshme, vepron **Inspektoriat i Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)** (<https://www.ikmt.gov.al/>), i cili mbulon me veprimtarinë e tij veprat penale të mjedisit, të cilat çënojnë territorin.

## 2.2 Institucionet në nivelin vendor

Në autoritetet publike të administrimit të mjedisit bëjnë pjesë edhe institucionet dhe organet e qeverisjes vendore, të cilat ngarkohen me ligj për administrimin e mjedisit dhe të përbërësve të tij.

Organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV) në Republikën e Shqipërisë, rregullohet me Ligjin 139/2015, i cili përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre, ku NJVV-të administrojnë ushtrimin e këtyre funksioneve në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.

Në **Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”** përcaktohen funksionet dhe kompetencat e NJVV-ve, kompetenca të cilat lidhen me mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit në territorin e tyre, përkatësisht:

Neni 23, mbi funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, parashikon se në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre edhe për:

- Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
- Ndriçimin e mjediseve publike.
- Transportin publik vendor.
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Neni 26, mbi funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit , parashikon se bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
- Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Neni 27 përcakton funksionet e NJVV-ve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversiteti duke i bërë ato përgjegjëse dhe për:

- Mënyrën e administrimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore si dhe të kategorive të tjera të burimeve natyrore.
- Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik.
- Mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të kenë struktura të veçanta për menaxhimin dhe administrimin mjedisor, por vetëm bashkitë e mëdha të tilla si Tirana e Shkodra kanë drejtori

apo sektorë mjedisi. Shumica e bashkive i mbulojnë përgjegjësitë e tyre për mjedisin në kuadër të Drejtorive të Shërbimeve Publike.

Policia Bashkiake ka për detyrë të monitorojë dhe të ndjekë të gjitha shkeljet administrative dhe dëmtimet e mjedisit në nivel vendor, duke u bashkërenduar edhe me institucionet e tjera të pranishme në këtë nivel.

Pas viteve 1990 dhe sidomos pas vitit 2010, Shqipëria ka arritur progres të rëndësishëm në miratimin e legjislacionit të ri mjedisor modern. Dinamika e ndryshimit të legjislacionit ka qenë e lartë, duke sjellë përmirësime ligjore të vazhdueshme. Ky proces u drejtua nga përpjekjet për përafrimin me *acquis* mjedisor të BE-së, sidomos pas marrjes së statusit të vendit kandidat në vitin 2014.

Megjithatë, disa akte nënligjore të domosdoshme ende mungojnë dhe zbatimi i legjislacionit ka mbetur prapa. Ndonjëherë, legjislacioni është shumë i avancuar kundrejt kapaciteteve administrative, institucionale apo burimeve financiare të vendosura në dispozicion të zbatimit të tij.

### 3.1 Marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore

Pas viteve 1990, ratifikimi i shpejtë i Marrëveshjeve Shumëpalëshe Mjedisore (në anglisht MEA) është dëshmi e politikës dhe rëndësisë që qeveria shqiptare i ka dhënë të qenit pjesëmarrëse e angazhuar në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e mjedisit. Aspirata për anëtarësim në BE është shtytësi kryesor për miratimin e legjislacionit të mjedisit në Shqipëri, ndërkohë që MEA-të mund të konsiderohen si një shtysë e dytë e madhe. Vetëm se reagimi efikas ndaj marrëveshjeve dhe angazhimeve ndërkombëtare kërkon rritjen e kapaciteteve dhe të burimeve financiare në të gjithë subjektet e përfshira.

Shqipëria ka bërë përpjekje për përmbushjen e detyrimeve të saj për raportimin në nivel ndërkombëtar. Megjithatë, mungesa e të dhënave të monitorimit për llojet dhe habitatet, cilësinë e ajrit dhe shkarkimet e gazeve serë kanë ndikuar në cilësinë e raportimit në kohë në këto fusha.

Ekziston një mungesë e përgjithshme e informacionit që duhet t'i jepet publikut nga autoritetet mjedisore shqiptare për statusin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në marrëveshjet globale, rajonale dhe dypalëshe, si dhe për zbatimin e këtyre marrëveshjeve.

Informacioni mbi statusin e vendit tonë në këto Marrëveshje Ndërkombëtare për Mjedisin mund të gjendet në faqet e internetit të Sekretariateve të secilës marrëveshje. Për secilën marrëveshje ku Shqipëria është palë nënshkruese, caktohet një nëpunës i ministrisë përgjegjëse për mjedisin si pika e kontaktit, që ka përgjegjësinë e komunikimit dhe të raportimit pranë sekretariateve përkatëse.

Për marrëveshjet më të rëndësishme, si Konventa Kuadër e OKB-së për Ndryshimet Klimatike,

botohen në faqen përkatëse të internetit edhe raportimet periodike që bën vendi. Për shembull disa nga raportet e dorëzuara nga qeveria shqiptare në kuadër të kësaj Konvente janë:

- Raporti i 4-t Kombëtar (nëntor 2022) <https://www.undp.org/albania/publications/fourth-national-communication-albania-climate-change>
- Raporti i Kontributit Vullnetar të Pikësnyuar (tetor 2021) <https://unfccc.int/sites/default/files/2022-08/Albania%20Revised%20NDC.pdf>

Në vijim po rendisim marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore ku Shqipëria është palë nënshkruese:

| Emri i konventës                                                                                         | Koha e ratifikimit                                 |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| Konventa Ramsar për ligatinat (1971)                                                                     | 29/02/1996                                         |
| Konventa për biodiversitetin                                                                             | pjesërisht nga 1994; pjesë të protokollit nga 2005 |
| Konventa e Bernës për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habiteteve Natyrore në Evropë. (1976)                 | 13/01/1999                                         |
| Konventa e UNESCO për mbrojtjen e Kulturës Botërore dhe Trashëgimisë Kulturore. (2003)                   | 10/07/1989                                         |
| Konventa kuadër e OKB për ndryshimet klimatike (UNFCCC)                                                  | 01/12/1994                                         |
| Konventa e Aarhus (1998), në vendimmarrje dhe e drejta për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore | 27/06/2001                                         |
| Konventa e Bonn (1979); për ruajtjen e specieve migratore dhe kafshët e egra                             | 01/09/2001                                         |
| Konventa e Barcelonës (1976); për mbrojtjen e Detit të Mesdheut nga ndotja                               | 09/07/2004                                         |
| Protokolli i Kyoto-s                                                                                     | 01/04/2005                                         |
| Konventa e UNESCO për ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003)                               | 04/04/2006                                         |
| Konventa Espoo: për VNM-në në kontekstin ndërkufitar së bashku me amendimet e protokollit (1991)         | 12/05/2006                                         |
| Konventa për mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore nënujore (2001)                              | 19/03/2009                                         |

## 3.2 Strategjitë kombëtare për çështjet mjedisore

Disa nga dokumentat strategjike të lidhura me menaxhimin mjedisor janë:

**Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit (SKNK) (2020-2030)** është dokumenti kryesor strategjik që adreson ndryshimet klimatike në Shqipëri. Strategjia është miratuar nga qeveria e Shqipërisë në vitin 2019 dhe është hartuar në mbështetje të legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën dhe synon fuqizimin e koordinimit mes sektorëve lidhur me masat e përshtatjes, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Fokusi i SKNK është zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

[https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit\\_Qershor-2019\\_-1.pdf](https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf)

**Dokumenti i Politikave dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (2020-2035)** është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jo-bashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri. Ai merr parasysh zhvillimet planifikuese dhe infrastrukturore në sektorin e mbetjeve prej vitit 2011, në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen e madhe të biznesit privat dhe investimet e shumta të kryera në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe veçanërisht të trajtimit të mbetjeve. Ai zhvillohet mbi konceptin “zero mbetje”, që synon që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi i tyre të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.

[https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike\\_AL.pdf](https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike_AL.pdf)

**Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (2015-2025)** ka për qëllim të jetë një udhërrëfyes për mënyrën se si vendi synon të përmbushë objektivat e Konventës për Mbrojtjen e Biodiversitetit në kontekstin e detyrimeve kombëtare.

<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-per-Mbrojtjen-e-Biodiversitetit.pdf>

**Dokumenti i Politikave për Sektorin e Pyjeve në Shqipëri (2018)** paraqet një analizë të gjendjes aktuale të pyjeve në Shqipëri dhe parashtrohet drejtimet politike të zhvillimit të këtij sektori për të arritur ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave.

<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/DPP-17.12.2018.pdf>

**Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (2017-2027)** është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave, për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit dhe shëndetit publik.

[https://www.erru.al/doc/Strategjia\\_Kombetare\\_e\\_Menaxhimit\\_te\\_Burimeve\\_Ujore.pdf](https://www.erru.al/doc/Strategjia_Kombetare_e_Menaxhimit_te_Burimeve_Ujore.pdf)

**Strategjia e Zhvillimit të Turizmit të Qëndrueshëm (2019-2023)** ka si objektiv promovimin e potencialeve turistike dhe krijimin e modelit të menaxhimit të destinacioneve të cilat kategorizohen si zonat natyrore dhe rurale që ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, malor, ekoturizmit dhe veprimtarive në natyrë.

<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

**Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Planin e Veprimit (2023-2030)** është dokumenti i parë për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, qëe synon zbutjen, parandalimin, përgatitjen dhe reagimin mbrojtës nga fatkeqësitë në Shqipëri. Ai synon të forcojë kapacitetin e vendit për të menaxhuar, përballuar dhe zvogëluar risqet nga fatkeqësitë natyrore, në përputhje me kuadrin Sendai dhe udhëzimet e BE-së dhe merr parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike në planet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, me fokus të veçantë vajzat dhe gratë dhe grupet vulnerabël.

<https://akmc.gov.al/miratimi-i-strategjise-kombetare-per-zvogelimin-e-riskut-nga-fatkeqesite-dhe-planin-e-veprimit/>

**Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2023-2030)** si një dokument strategjik, i cili është në harmoni të plotë me standardet dhe rekomandimet e BE-së përmbi avancimin e mëtejshëm të agjendës së decentralizimit, konsolidimin e arritjeve ekzistuese, duke u përpjekur për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo strategji synon përmirësimin e autonomisë në këndvështrimin financiar si dhe arritjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm. Planet e Përgjithshme Vendore të miratuara në të gjitha bashkitë, të cilat përmbajnë planet e propozimeve të zhvillimit territorial, shërbimet infrastrukturore, planin e investimeve kapitale, zonat për zhvillim ekonomik dhe tipologjitë hapësinore.

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/04/20/252>

### 3.3 Kuadri ligjor specifik për mjedisin

Kuadri ligjor për mjedisin përfshin ligjin kuadër Për Mbrojtjen e Mjedisit, ligjet specifike, si dhe aktet nënligjore si VKM dhe Urdhra, të cilat janë në ndryshim të vazhdueshëm. Procesi i përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, ka sjellë ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme. Një përmbledhje e kuadrit aktual gjendet në tabelën e mëposhtme, ndërsa për të ndjekur ndryshimet e mundshme në vitet në vijim, referojuni në mënyrë periodike faqet së internetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (<https://turizmi.gov.al/strategjia-e-mjedisit/>), si dhe faqeve të agjencive që mbulojnë fusha specifike të mjedisit.



## **Tabela: Kuadri aktual rregullator mbi mjedisin në Shqipëri**

### **Ligji bazë i mbrojtjes së mjedisit**

Ligj Nr 10431, datë 9.06.2011 Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar

### **Pyje dhe kullotat**

Ligj Nr. 57 date 30.4.2020 Për Pyjet

Ligj Nr. 5/2016 Për Shpalljen e Moratoriumit në Pyje në Republikën e Shqipërisë

Ligj Nr. 9693 datë 19.3.2007, Për Fondin Kullosor, i Ndryshuar me Ligjin Nr. 49/2016 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, Për Fondin Kullosor, të Ndryshuar

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit Nr. 1, datë 26.01.2017 Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar

### **Zonat e mbrojtura dhe Biodiversiteti**

Ligj Nr. 7, datë 30.01.2014 Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë

Ligj Nr. 81, datë 04.05.2017 Për Zonat e Mbrojtura

VKM Nr.57, datë 6.2.2019 Për Kriteret dhe Mënyrën e Zonimit të Territorit të një Zone të Mbrojtur Mjedisore

VKM Nr.369, datë 29.5.2019 Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes

VKM Nr.303, datë 10.5.2019 Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare

VKM Nr. 593, datë 9.10.2018 Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura mjedisore

### **Leje të mjedisit/ndotja industriale**

Ligj Nr. 10448 (2011) Për Lejet e Mjedisit

Ligj Nr. 10448 ndryshuar me Ligjin Nr. 60 (2014) Për disa ndryshime në Ligjin Për Lejet e Mjedisit

VKM Nr. 372 (2016) Për leje mjedisi tipi A ndërkufitare

VKM Nr. 372, amenduar me VKM Nr. 96 (2018) Për leje mjedisi tipi A ndërkufitare

VKM Nr. 419 (2014) Për miratimin e kërkesave për shqyrtimin për leje mjedisi

VKM Nr. 419 amenduar me VKM Nr. 97 (2018) Për miratimin e kërkesave për shqyrtimin për leje mjedisi

### **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis**

Ligj 10440 (2011) Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

VKM Nr. 247 (2014) Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore

VKM Nr. 598 (2015) Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar

VKM Nr. 912 (2015) Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis

### Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Ligj Nr. 91/2013 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

VKM Nr. 219 (2015) Për konsultimin publik në procesin e VSM

VKM Nr. 507 (2015) Për listen e planeve dhe programeve që i nënshtrohen VSM

VKM 620 – 2015 Për procedurën ndërkufitare të VSM

Udhëzim Nr. 6 (2016) Për miratimin e Metodikës Kombëtare të Vlerësimit Strategjik

### Menaxhimi i mbetjeve

Ligj 10463, datë 22.09.2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

VKM Nr. 319, datë 31.05.2018 Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve

VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte

VKM Nr. 608, datë 17.09.2014 Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre

VKM Nr. 652, datë 14.09.2016 Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura

VKM Nr. 371, datë 11.06.2014 Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme

VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim

VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 Për lëndfilllet e mbetjeve

VKM Nr. 765, datë 07.11.2012 Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura

VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"

VKM Nr. 957, datë 19.12.2012 Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike

VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve

VKM Nr. 99, datë 18.02.2005 Për miratimin e katalogut shqipëtar të mbetjeve

VKM Nr. 705, datë 10.10.2012 Për automjetet e dala jashtë përdorimit

VKM Nr. 866, datë 04.12.2012 Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre

Udhëzim 1738, datë 12.03.2015 Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane

### Ajri

VKM Nr. 162, datë 19.02.2020 Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër

Ligj 162-2014, datë 04.12.2014 Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis

VKM Nr. 412, datë 19.6.2019 Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit

VKM Nr. 435, 2002 Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër

## Kimikate

Ligj Nr. 27/2016 Për Menaxhimin e Kimikateve

VKM Nr. 860, datë 20.12.2006, Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm

VKM Nr. 447, datë 19.9.1994 Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit

VKM Nr. 488, datë 29.6.2016 Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve

VKM Nr. 9, datë 9.1.2019 Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë

VKM Nr. 319, datë 15.5.2019 Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm

VKM Nr. 665, datë 21.9.2016 Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme

## Zhurmat

Ligj Nr. 9774 datë 12.7.2007 Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis

VKM Nr. 4492 datë 7.11.2007 Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike

## Substancat ozon holluese

VKM Nr.10, datë 9.1.2019 Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca.

VKM Nr. 453, datë 23.6.2005 Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese

## Ndryshimet klimatike

Ligji nr. 155, datë 17.12.2020: Për Ndryshimet Klimatike

Shqipëria ka përjetuar rritje të dukshme ekonomike dhe ulje të varfërisë. Aksesit në arsim, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet për qytetarin janë përmirësuar dhe është rritur shkalla e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikëbërje, falë rritjes së komunikimit digjital dhe përdorimit të internetit. Megjithatë, pavarësisht zhvillimeve pozitive në ekonomi, mbeten mangësi dhe sfida të konsiderueshme lidhur me mjedisin. Zhvillimi ekonomik i shpejtë ka krijuar presione të shtuara në shfrytëzimin e burimeve natyrore, duke zvogëluar stokun e tyre, prej shfrytëzimit dhe ndotjes.

Shumë sfida mjedisore mbeten të pazgjidhura dhe janë bërë më të mprehta. Shkarkimet e gazeve serë vazhdojnë të rriten. Zonat urbane dhe bregdetare janë bërë më të dendura prej ndërtimeve intensive, ndërsa kërkesa për lëvizshmëri me mjete private është në rritje. Veçanërisht në vitet e fundit, ndryshimet klimatike kanë sjellë ngjarje ekstreme të motit si thatësira dhe përmbytje, valë të nxehti të shpeshta dhe jo vetëm gjatë muajve të verës, të cilat kanë rënduar efektin e problemeve mjedisore në vend.

Ndotja e burimeve ujore dhe e mjedisit detar është shqetësim serioz, veçanërisht afër qyteteve dhe vendeve industriale, për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza dhe hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve. Ndotja nga plastika përgjatë lumenjve dhe bregdetit po bëhet gjithnjë edhe më shqetësuese.

Erozioni dhe ndotja e tokës përbëjnë shqetësime të mëdha, sepse ky burim natyror është mjaft i kufizuar. Erozioni mbetet mjaft i lartë jo vetëm prej terrenit malor të vendit, por edhe nga praktikatat e paqëndrueshme në shfrytëzimin e pyjeve dhe kullotave. Ndotja e tokës është një problem jo shumë i njohur, por vlerësohet se ndërmarrjet industriale të braktisura, minerat dhe venddepozitimet e mbetjeve janë burime ndotëse të shpërndara në të gjithë vendin. Shumë probleme mjedisore janë të ndërlidhura dhe përkeqësojnë disa tregues mjedisorë njëkohësisht.

Sipas Indeksit të Performancës Mjedisore (EPI) ([www.epi.yale.edu](http://www.epi.yale.edu)), për vitin 2022, Shqipëria renditet në vendin e 62-të ndër 180 vendet e vlerësuar nga Universiteti i Yale (SHBA) me 47,1 nga 100 pikë. Ky Indeks i rendit vendet sipas një sërë treguesish të performancës për politikatat mjedisore dhe të shëndetit. Vlerësimi i krahasuar me një vit më parë për hartimin e politikave mjedisore është përmirësuar me +9,9 pikë. Ndonëse ka përparim në zhvillimin e politikave mjedisore, sfida qëndron në zbatimin e tyre dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Raportet e Komisionit Europian mbeten kritike për kapitullin 27: Mjedisi dhe klima. Në raportin e vitit 2022 theksohet se *“Shqipëria tregon një nivel përgatitjeje në këtë fushë. Është bërë përparim i kufizuar në përafrimin e politikave dhe legjislacionit me acquis të BE-së, në fusha të tilla si menaxhimi i ujit, kimikatet dhe krimi mjedisor. Shqipëria ka bërë progres në fushën e mbrojtjes civile dhe është gati për t’iu bashkuar Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Unionit.*

*Shqipëria duhet megjithatë të vazhdojë duke punuar për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të tij të mbrojtjes civile. Duhet përpjekje të konsiderueshme për zbatimin, veçanërisht për menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujit dhe ajrit dhe ndryshimi i klimës”<sup>1</sup>*

Në vijim po rendisim disa problematika mjedisore në periudhën 2020-2023, të trajtuara në media, në reflektim të shqetësimit publik të komuniteteve dhe shoqërisë civile mjedisore.

### **1. Dëmtimi i rrjedhave ujore prej ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël.**

Dhënia e mbi 730 lejeve për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël pas viteve 2010, solli një dëmtim të konsiderueshëm, shpesh të parikthyeshëm, në përrrenjtë dhe lumenjtë në mbarë vendin. Mungesa e studimeve mjedisore, shfrytëzimi i plotë e sasisë së ujit në rrjedhë dhe dëmtimet gjatë punimeve për ndërtimin e tyre kanë sjellë reagimin e komuniteteve vendore dhe shoqërisë civile me protesta, padi civile dhe veprime të tjera kundërshtuese. Media ka trajtuar me vëmendje të veçantë rastet në lumenjtë Rrapun (Librazhd), Valbonë (Tropojë), Zall Gjoçaj (Bulqizë), etj.

### **2. Rivlerësimi (zvogëlimi i zonave të mbrojtura bregdetare)**

Gjatë një procesi rivlerësues, në 2019, AKZM propozoi ndryshimin e kufijve të zonave të mbrojtura. Mbi bazën e këtij studimi, qeveria miratoi me VKM kufinj të rinj të zonave të mbrojtura, duke cënuar 11% të sipërfaqes së zonave të mbrojtura në bregdet, kryesisht në zonat lagunore të vendit. Ndonëse në shkallë vendi, sipërfaqja e mbrojtur u rrit deri në 20,9% të territorit, ajo në pjesën bregdetare u zvogëlua, duke i dhënë mundësi projekteve zhvillimore turistike. Me shqetësimin për ndikimin negativ mbi këto zona të veçanta natyrore me pasuri të madhe të biodiversitetit, kryesisht të shpendëve folezues dhe migratorë, shoqëria civile mjedisore, pas një sërë veprimesh lobuese, ka paditur qeverinë për zhvillimin e një procesi jo të drejtë vlerësimi për këto zona.

### **3. Ndërtimi i aeroportit të Vlorës**

Qeveria shqiptare ka miratuar projektin për ndërtimin e aeroportit të Vlorës brenda zonës së mbrojtur të Nartës. Punimet janë në proces, ndonëse janë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura. Shoqëria civile ka kundërshtuar procesin duke e vlerësuar dokumentin e VNM-së si jo të saktë dhe me mangësi të theksuara. Ajo ka paditur qeverinë dhe e ka adresuar çështjen pranë Sekretariateve të Konventave Ndërkombetare që merren me mbrojtjen e faunës së egër.

---

<sup>1</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)

## KAPITULLI 5

### BURIME TË INFORMACIONIT MJEDISOR

Ky kapitull përmbledh burimet kryesore të të dhënave mjedisore mbi Shqipërinë të ofruara nga institucionet publike vendase.



Dokumenti më gjithëpërfshirës ofrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila ka përgjegjësinë institucionale të botojë çdo vit Raportin e Gjendjes së Mjedisit, i cili përmban informacion të detajuar mbi të gjithë treguesit e monitoruar të mjedisit, sipas Planit të Monitorimit të miratuar.

Ky dokument mund të shkarkohet në faqen e internetit të AKM: <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

Në vijim po paraqesim burime të informacionit sipas fushave specifike të mjedisit.

### 5.1 Burimet ujore


Në kategorinë e burimeve ujore bëjnë pjesë: ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore. Ujërat sipërfaqësore janë një kategori e gjerë ku përfshihen trupat e mëdhenj ujorë të ujërave të ëmbël si liqenet natyrore dhe artificiale (të hidrocentraleve, për qëllime turistike, pushimi, sportive), lumenjtë dhe përrenjtë, ligatinat dhe rezervuarët për ujitje, kultivim peshku, etj. Në ujërat sipërfaqësorë përfshihen edhe ujërat e larjes përgjatë bregdetit, të cilat shërbejnë kryesisht për qëllime pushimi dhe sportive gjatë sezonit të verës.

Burimet e informacionit:

#### ● Agjencia e Menaxhimit të Baseneve Ujore ([www.ambu.gov.al](http://www.ambu.gov.al))

Kjo agjenci mirëmban regjistrin e kadastrës ujore të vendit. Në të informacioni është i organizuar sipas baseneve lumore. Ky informacion mund të aksesohet në faqen e internetit

<http://kadastraujore.gov.al/>



**Figura 1:** Hartë e kadastrës ujore për basenin e lumit Ishëm (Burimi: AMBU)

AMBU ka hartuar Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore pothuajse për të gjithë basenet lumore. Këto plane mund të shkarkohen në faqen e internetit të kësaj Agjencie, në seksionin Publikime: <http://www.ambu.gov.al/plani-i-menaxhimit-te-basemit-ujor-seman/>


| Zona                                                           |                                               |
|----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )                                  | 5,649                                         |
| Burimet ujore                                                  |                                               |
| Numri i lumenjve kryesorë                                      | 1                                             |
| Numri i degëve                                                 | 3                                             |
| Gjatësia e lumit (km)                                          | 281                                           |
| Prurjet mesatare vjetore (m <sup>3</sup> /s)                   | 83.2                                          |
| Cilësia e ujërave sipërfaqësore                                | Mesatar                                       |
| Numri i liqeneve të mëdhenj                                    | -                                             |
| Numri i rezervuarëve bujqësorë                                 | 211                                           |
| Numri i akuiferëve kryesorë të përdorur (Banka Botërore, 2012) | 2                                             |
| Përdorimi i ujit                                               |                                               |
| Rezervuarët bujqësorë                                          | Përdorim i lartë                              |
| Numri i hidrocentraleve të mëdha                               | 1 + 1 në ndërtim                              |
| Numri i hidrocentraleve të vegjël me koncesion                 | 47 të një totali prej 96 HEC-esh <sup>9</sup> |
| Përdorimi i ujit të pijshëm                                    | I lartë                                       |
| Përdorimi sipas industrive                                     | Përdorim i lartë                              |
| Potencial për hotspot-et e ndotjes                             | Mesatar                                       |
| Numri i Zonave të Mbrojtura                                    | 11                                            |
| Rëndësia e mbulesës pyjore                                     | Rëndësi mesatare                              |
| Përdorime të tjera                                             | Peshkim                                       |
| Rrezik nga thatësira                                           | Mesatar                                       |
| Rrezik nga përmytjet                                           | I lartë                                       |
| Demografia                                                     |                                               |

**Figura 2:** Tabelë ilustruese e informacionit rreth përdorimit të ujit në basenin e lumit Seman (Burimi: AMBU, Plani i Menaxhimit të Basenit të lumit Seman, 2019)



## Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ([www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))

Bazuar në studimet e shumta mbi burimet ujore, ShGjSh ka hartuar Hartën Hidrogjeologjike për të 61 bashkitë e vendit. Hartën e çdo bashkie (Shkalla 1:50000) mund ta shkarkoni nga faqja e internetit: <http://www.gsa.gov.al/Sherbimet/hartat.html>



**Figura 3:** Model i Hartës Hidrogjeologjike për Bashkinë Lezhë, Viti 2015 (Burimi: [www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit: ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al))** publikon të dhënat nga monitorimi i ujërave sipërfaqësore sipas planit kombëtar të monitorimit. Këto të dhëna janë të grupuara për basenet lumore, liqenet dhe bregdetin. Pikat e monitorimit dhe cilësia e ujërave në këto pika gjenden në faqen e internetit <https://akm.gov.al/monitorime/>. Në AKM ka stacione monitorimi në territorin e bashkisë suaj, ku informacioni mund të përfshihet në vlerësimin e kapitalit natyror lidhur me cilësinë e ujërave.

### Stacionet e Monitorimit të Lumenjve

#### Cilësia e Ujit

Cilësi e Lartë


Cilësi e Mirë

Cilësi e Moderuar

Cilësi e Varfër

Cilësi e Keqe

### Baseni i Drinit



**Figura 4:** Të dhëna për cilësinë e ujërave të lumit Drin (Burimi AKM, 2022)




Nërkohë, të dhëna sasiore për nivelet e ndryshme të parametrave fiziko kimikë botohen në Raportin e Gjendjes së Mjedisit, i aksesueshëm në faqen e internetit <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>


| Nr. | Kodi i kampionit | Emërtimi i Lumit | Vendndodhja                     | Koordinatat gjeografike |
|-----|------------------|------------------|---------------------------------|-------------------------|
| 1.  | D1               | Drini i Zi       | Topojan- Ura Burrel -Peshkopi   | N 41.580626 E 20.434238 |
| 2.  | D2               | Drini            | Bahçallek - Ura Bahçallek       | N 42.041771 E 19.490806 |
| 3.  | D3               | Drini i Bardhë   | Luma - Kukës                    | N 42.040408 E 20.274955 |
| 4.  | Bu1              | Buna             | Muriqan - afër fshatit, në kufi | N 42.009313 E 19.411012 |
| 5.  | Bu2              | Buna             | Ura e vjetër Shkodër - Shirokë  | N 42.045851 E 19.487121 |
| 6.  | DLe              | Drini Lezhë      | Kune-Vain para derdhjes në det  | N 41.753554 E 19.593363 |

**Figura 5:** Të dhëna për stationet e monitorimit dhe cilësinë e ujërave të lumit Drin (Burimi AKM, Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2021)

Grafiku 1. Vlerat mesatare,  $O_2$  i tretur, mg/l




Grafiku2. Vlera mesatare  $NO_3^-$ , mg/l



## Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor ([www.asig.gov.al](http://www.asig.gov.al))

Në portalin e këtij institucioni mund të merret informacion rreth trupave më të vegjël ujorë siç janë rezervuarët, kënetat dhe ligatinat, etj. Në faqen e internetit të kësaj agjencie <https://geoportal.asig.gov.al/map/?themeld=3805251&auto=true>, mund të përzgjidhen temat si p.sh., hidrologjia, dhe gjenden harta GIS, siç është ilustruar në figurën më poshtë:



**Figura 6:** Të dhëna për rrjetin hidrologjik në nivelin vendor (Burimi ASIG, Geoportali)

## Instituti i Gjeoshkencave ([www.geo.edu.al/Sherbimet/Departamenti\\_i\\_Hidrologjise/](http://www.geo.edu.al/Sherbimet/Departamenti_i_Hidrologjise/))


Departamenti i Hidrologjisë (DH) pranë këtij instituti ofron një sërë shërbimesh hidrologjike dhe hidraulike dhe boton Buletinin e Rreziqeve Natyrore, mat nivelet e ujit, prurjeve, kryen analiza statistikore të prurjeve të ujit, harton raporte të veçanta hidrologjike, studime hidraulike dhe harta të rrezikut nga përmbytjet.

**Ujërat nëntokësore** janë një kategori shumë e rëndësishme e burimeve ujore. Informacioni për to është jo i plotë dhe shpesh stoku i tij është i panjohur.

Burimi kryesor i informacionit për ujërat nëntokësore është:

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit:** ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)) që publikon serinë e të dhënave nga monitorimi i ujërave nëntokësore sipas planit kombëtar të monitorimit. Këto të dhëna janë të grupuara për basenet lumore. Pikat e monitorimit për veçoritë hidrodinamike dhe cilësinë e ujërave në këto pika, gjenden në faqen e internetit <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

Nëse AKM ka stacione monitorimi (pikë shpime) në territorin e një bashkie, informacioni lidhur me cilësinë e ujërave botohet në Raportin e Gjendjes së Mjedisit.




**Figura 7:** Të dhëna për monitorimin sasior dhe hidrodinamik në nivelin maksimal dhe minimal në basenin e lumit Ishëm-Erzen (Burimi AKM, RGJM 2021).

## 5.2 Pyjet dhe kullotat

Për vlerësimin e sipërfaqeve pyjore, të kullotave si dhe sipërfaqeve të tjera mund të përdoren hartat GIS të ASIG, për mbulesën e tokës sipas sistemit Corine 2018.

<https://geoportal.asig.gov.al/map/?themeld=3805251&auto=true>



**Figura 8:** Të dhëna për vlerësimin e mbulesës së tokës në nivelin vendor (Burimi ASIG, Geoportali)

## 5.3 Biodiversiteti

Në këtë kategori bëjnë pjesë të gjithë vlerat natyrore, të cilat lidhen me tre nënkategoritë e shumëllojshmërisë biologjike (ose biodiversitetit): a) Biodiversiteti llojor, përfshirë florën dhe faunën; b) biodiversiteti gjenetik, përfshirë racat dhe ekotipet; c) biodiversiteti i habitateve dhe ekosistemeve.

**Biodiversiteti llojor** përfshin të gjitha llojet e gjallesave njëqelizore dhe shumëqelizore. Për shkak të të dhënave të disponueshme nga monitorimet në natyrë, nënkategoritë më të referuara janë Flora dhe Fauna, ku kryesisht jepen të dhëna për bimët e larta me lule dhe vertebrorët (shpendë dhe gjitarë). Një përshkrim më i plotë i kësaj kategorie përmban të dhëna mbi llojet dhe përhapjen e tyre në territorin e njësisë vendore sipas grupeve të mëposhtme:

### Flora:

- Fiernat,
- Gjimnospermët dhe
- Angiospermët

### Fauna:

- Parruazorët, ku përfshihen krimbat e shiut, molusqet dhe kërmijnjtë, arthropodët përfshirë merimangat dhe insektet; dhe;
- Rruazorët, ku përfshihen peshqit, amfibët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët.

### Kërpudhat.

Biodiversiteti llojor është tregues i drejtpërdrejtë i shëndetit të një zone të caktuar. Të dhënat për këtë nënkategori duhet të përmbajnë listën llojore, popullatat me numrin e individëve për secilën prej tyre, dhe përhapjen në territor.

Shumë lloje, sidomos insektesh, amfibësh, shpendësh dhe gjitarësh, vlerësohen të rrezikuara për t'u zhdukur meqenëse popullatat e tyre janë në rënie në nivel global ose në një territor të caktuar. Për këtë arsye, duhet shënuar edhe statusi i tyre p.sh., *i kërcënuar për t'u zhdukur*, sipas kategorive të IUCN. Gjithashtu me vlerë të veçantë është edhe përcaktimi nëse një lloj është endemik (gjendet vetëm në atë territor), sub-endemik (gjendet vetëm në atë rajon).

Të dhënat për zonat e mbrojtura dhe për llojet me rëndësi të veçantë siç janë gjitarët e mëdhenj, shpendët grabitqarë, etj. dhe llojet endemikë, më së shumti, grumbullohen nga institucionet e përcaktuara për monitorimin e faunës dhe florës, si Qendra e Florës dhe Faunës (Universiteti i Tiranës) dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura.

Burimet kryesore të informacionit për këtë kategori janë:

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** ([www.akzm.gov.al](http://www.akzm.gov.al)) ka të publikuar në faqen e internetit (<https://akzm.gov.al/zonat-e-mbrojtura/>) të gjithë rrjetin e zonave të mbrojtura në të cilin jepen të dhëna fillestare rreth listës së llojeve kryesore dhe numrit të tyre në këto zona.

Informacion më të thelluar mund të merret nga Planet e Menaxhimit të çdo Parku Kombëtar, pranë Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura. Kjo administratë ka për detyrë monitorimin e llojeve brenda kufijve të parkut kombëtar.

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit:** ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)) publikon të dhënat nga monitorimi i biodiversitetit sipas planit kombëtar të monitorimit. Informacion sasior mbi lloje të veçanta gjendet në faqen e internetit <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

| Nr. | Vendnumërimet       | Individë | Specie |
|-----|---------------------|----------|--------|
| 1   | Divjakë-Karavasta   | 34241    | 53     |
| 2   | Bunë-Velipojë       | 1646     | 22     |
| 3   | Liqeni i Shkodrës   | 20098    | 20     |
| 4   | Kune-Vain           | 9458     | 41     |
| 5   | Patok               | 1981     | 23     |
| 6   | Sektori Rinia-Lalëz | 7278     | 26     |
| 7   | Shëna-Vlash         | 128      | 6      |
| 8   | Karpen              | 96       | 8      |
| 9   | Fierzë              | 624      | 7      |
| 10  | Seman               | 40       | 8      |
| 11  | Liqeni i Thanës     | 9850     | 21     |
| 12  | Liqenet e Belshit   | 207      | 10     |
| 13  | Liqeni i Banjës     | 83       | 7      |
| 14  | Vjosë-Nartë         | 11291    | 39     |

**Figura 9:** Të dhëna nga monitorimi i shpendëve për vitin 2021 (Burimi: AKM, RGJM 2021)


Grumbullimi i të dhënave për biodiversitetin është më i vështirë për territoret që janë jashtë zonave të mbrojtura, ku monitorimi është më i pakët ose mungon tërësisht. Informacioni për të gjithë territorin e bashkisë duhet mbledhur nga specialistët vendorë, shoqatat e gjuetarëve sportivë, kërkues shkencorë të institucioneve kërkimore që kanë realizuar vlerësime (të plota ose të pjesshme) për grupe dhe lloje të veçantë. Këto institucione kërkimore kanë edhe baza të dhënash për lloje të veçantë dhe që mbulojnë të gjithë territorin e vendit.

**Qendra e Florës dhe Faunës**, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universitetit të Tiranës (<https://fshn.edu.al/departments/qendra-kerkimore-e-flores-dhe-faunes>)

**Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor** ([www.asig.gov.al](http://www.asig.gov.al))

Në portalin e këtij institucioni mund të merret informacion rreth mbulesës vegetative të territorit. Në faqen e internetit të kësaj agjencie (<https://geoportal.asig.gov.al/map/?themeld=3805251&auto=true>) mund të përzgjidhen temat si p.sh. Zonat Ekologjike dhe Shpërndarja e llojeve, dhe gjenden harta GIS, sikundërse është ilustruar në figurën më poshtë.





**Figura 10:** Të dhëna për zonat ekologjike dhe shpërndarjen e llojeve (Burimi ASI.G, Geoportali)

## 5.4 Monumentet e natyrës

Në këtë kategori duhet të renditen të gjitha monumentet natyrore, përfshirë gjeomonumentet dhe të bimësisë që gjenden në territorin e çdo bashkie. Të tilla mund të jenë drurë të vjetër, bimë të rralla endemike, shpella, kanione, shkëmbinj me formë të veçantë apo fenomene natyrore te veçanta.


Të dhënat për monumentet e natyrës mund të gjenden lokalisht, nëpërmjet specialistëve të fushës. Ato duhet të përmbajnë informacion mbi llojin dhe vendndodhjen/përhapjen.

Bazat e të dhënave, me mbulim kombëtar për informacionin mbi monumentet natyrore gjenden pranë institucioneve të mëposhtme:

### Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ([www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))

ShGjSh ka hartuar Hartën e Gjeomonumenteve për 61 bashkitë e vendit. Hartën (Shkalla 1:50000) mundet ta shkarkoni në faqen e internetit:

<http://www.gsa.gov.al/Sherbimet/hartat.html>



**Figura 11:** Model i Hartës së Gjeomonumenteve për Bashkinë Tiranë, Viti 2015 (Burimi: [www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** ([www.akzm.gov.al](http://www.akzm.gov.al)) ka të publikuar në faqen e internetit (<https://akzm.gov.al/monument-natyror>), informacione rreth monumenteve natyrore në mbarë vendin.

## 5.5 Burimet minerare


Sasia e këtyre burimeve mund të vlerësohet bazuar në studimet gjeologjike të kryera nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe në studime të ndryshme pjesore për vendburime të caktuara.

Burimi e të dhënave:

**Shërbimi Gjeologjik Shqiptar** ([www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))

Bazuar në studimet e shumta mbi pasuritë minerare të vendit, ShGjSh ka hartuar Hartën Gjeologjike dhe Hartën e Pasurive Minerare për të 61 bashkitë e vendit. Hartën (Shkalla 1:50000) mundet ta shkarkoni në faqen e internetit:

<http://www.gsa.gov.al/Sherbimet/hartat.html>



**Figura 12:** Model i Hartës së Pasurisë Minerare për Bashkinë Mirditë, Viti 2016 (Burimi: [www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))

Në të janë të listuar përbërësit e disa kategorive, si qymyre, mineralet metalore (bakër, hekur, nikel, krom, etj), mineralet jometalore (gëlqerorët, kuarci dhe rërë kuarci, gurë dhe mermere, rëra bitumoze, argjila), etj.

## 5.6 Burimet energjetike

### *a) Burimet energjetike me bazë karboni*

Në burimet energjetike bëjnë pjesë burimet energjetike me bazë karboni: nafta, gazi, qymyret

dhe torfa. Studimet dhe të dhënat për këtë nënkategori mund të gjenden në këto institucione:

- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ([www.gsa.gov.al](http://www.gsa.gov.al))
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ([www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al))
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ([www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al))

Të dhënat për sasitë e nxjerra të naftës dhe gazin sipas vendburimeve mund të gjenden në faqen e internetit të AKBN: Drejtoria Hidrokarbure (<http://www.akbn.gov.al/category/drejtoria-hidrokarbure-shkencore/>), ku mund të merrni të dhënat e vendburimeve që ndodhen sipas bashkive, si në shembullin e tabelës në vijim:

**PRODHIMI I NAFTËS DHE GAZIT NË SHOIPËRI PËR VITIN 2019**

| NR | KOMPANIA / V.B.                               | Prodhim Naftë       |                           | Prodhim Gaz |                  |
|----|-----------------------------------------------|---------------------|---------------------------|-------------|------------------|
|    |                                               | Në ton              | Në % ndaj prodhimit total | Gaz Natyror | Gaz Shoqëruar    |
| 1  | Albpetrol sh.a.                               | 75.415,00           | 7,52                      | 0,00        | 2.060,50         |
| 2  | Bankers Petroleum Albania Ltd (Patos-Marinez) | 885.692,00          | 88,13                     | 0,00        | 76.814,00        |
| 3  | Sherwood International (Kuçove)               | 1.172,00            | 0,11                      | 0,00        | 231,00           |
| 4  | Delvina Gas Group (Delvine)                   | 0,00                | 0,00                      | 0,00        | 0,00             |
| 5  | Anio Oil (Ballsh-Hekal)                       | 24.439,00           | 2,43                      | 0,00        | 539,00           |
| 6  | Terra Oil Swiss (Transoil Group/Visokë)       | 17.778,00           | 1,77                      | 0,00        | 422,00           |
| 7  | Fin-Pek (Finiq-Krane, Pekisht-Murritz)        | 502,00              | 0,04                      | 0,00        | 0,00             |
|    | <b>Totali</b>                                 | <b>1.004.998,00</b> | <b>100,00</b>             | <b>0,00</b> | <b>80.066,50</b> |

**Figura 13:** Shembull i sasive të nxjerra për naftën dhe gazin sipas vendburimeve (Burimi: AKBN).

## b) Burimet energjetike të rinovueshme

Në këtë kategori bëjnë pjesë energjia e prodhuar nga burimet hidrike, energjia diellore, energjia e erës, biomasa dhe energjia gjeotermike. Për bashkitë në zonën bregdetare të vendit mund të listohen edhe nën kategori të tjera nëse ka studime vlerësimi si për shembull energjia e valëve.

**Energjia hidrike:** Për energjinë nga burimet hidrike ka vlerësime të detajuara për secilën njësi vendore, të cilat gjenden në Agjencinë Kombëtare e Burimeve Natyrore ([www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)).

Të dhënat për çdo bashki mund të merren pranë Drejtorisë së Monitorimit të Hidrocentraleve në AKBN. (<http://www.akbn.gov.al/category/drejtoria-e-monitorimit-te-hidrocentraleve-shkencore/>)

**Figura 14:** Hartë e vendosjes së hidrocentraleve të mëdhenj dhe të vegjël (Burimi: AKBN, 2019)



**Energjia diellore:** Të dhënat mbi kapacitetet e instaluara të impianteve të energjisë diellore dhe potencialet për zhvillimin e saj në nivel vendor mund të merren pranë AKBN, Drejtoria e Energjive të Rinovueshme.

**Figura 15:** Harta e mesatares ditore të rrezatimit diellor në Shqipëri në kWh/m<sup>2</sup>/vit (Burimi: AKBN 2019)



### **Energjia e erës dhe gjeotermale:**

Kapacitetet në nivel vendi janë ende në fazë vlerësimi. Studimet e deritanshme janë shtrirë në disa rajone të vendit, ndaj edhe të dhënat për këtë lloj energjie janë ende të kufizuara. Për shkak të investimeve të pakta në këtë sektor deri më sot, mund të përlogaritet vetëm me afërsi potenciali i prodhimit të energjisë nga këto burime.

Vlerësime të përafërta mbi potencialet e erës dhe ato gjeotermike mund të merren pranë AKBN, Drejtoria e Energjive të Rinovueshme.

**Figura 16:** Harta e shpejtësisë mesatare të erës (m/s) në Shqipëri (Burimi: AKBN 2019)



Reporterët duhet të përpiqen t'i tregojnë shikuesve dhe lexuesve të tyre ngjarje të rëndësishme të ditës dhe asgjë nuk është më urgjente se sa ndryshimet klimatike.

Pavarësisht se pranohet gjerësisht se bota po ndryshon me shpejtësi dhe se ndikimi i ndryshimeve klimatike mund të jetë shkatërrimtar, shumë vijojnë ta shohin atë më së shumti si koncept abstrakt se sa si një kërcënim të afërt.

Për rrjedhojë, është e domosdoshme që gazetarët t'i shpjegojnë publikut se pse kanë rëndësi ndryshimet klimatike. Në mënyrë që ta bëjnë këtë, ata duhet të sigurohen që ky lajm global të jetë pasqyrohet kundrejt çështjeve vendore, të cilat kanë rëndësi për jetën e përditshme, si dhe të sfidojnë skeptikët e ndryshimeve klimatike.

Në procesin e raportimit të kësaj teme, është gjithashtu me rëndësi thelbësore që gazetarët të kuptojnë dhe përcjellin qartë se çfarë është dhe çfarë nuk është ndryshim i klimës. Për shembull, nuk e ndihmon publikun të kuptojë problemin nëse të gjitha ngjarjet e motit i vishen, pa arsye të shëndoshë, ndryshimeve klimatike.

Ky kapitull do të parashtrojë përkufizimin e ndryshimeve klimatike, se si gazetarët duhet të menaxhojnë skeptikët e ndryshimeve klimatike dhe se si kriza botërore mund të bëhet domethënëse për lexuesit në Shqipëri.

## 6.1 Ndryshimet klimatike - koncepte themelore

**Jo të gjitha ngjarjet ekstreme të motit lidhen me ndryshimet klimatike**

Ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike janë terma që shpesh përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit dhe po kështu ndodh edhe me fjalët *mot* dhe *klimë*. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet dallimi mes tyre.

*Moti* është ai që ne zakonisht shohim në buletinet televizive në mbrëmje, të cilat na thonë se cila pritet të jetë temperatura apo shpejtësia e erës ditën tjetër dhe nëse pritet apo jo të bjerë shi apo do të jetë diell.



**Figura 17:** Parashikimi i motit në BBC, i cili nuk është parashikim i klimës

Klima i referohet kushteve afatgjata dhe se si ato do të evoluojnë përgjatë periudhave të gjata, dhjetëvjeçarë e më shumë.

Një valë moti të nxehtë apo një stuhi shkatërrimtare nuk janë ndryshime klimatike, por ngjarje të motit, të cilat mund të jenë, por edhe mund të mos jenë shkaktuar nga ndryshimet e klimës.

Në pranverën e vitit 2023, Italia, dhe në një masë më të vogël edhe Shqipëria, u goditën nga një numër stuhish, të cilat shkaktuan përmbytje shkatërrimtare dhe i morën jetën 17 njerëzve në Itali.

A ishin këto ngjarje të jashtëzakonshme të motit rezultat i ndryshimeve klimatike? E pra, shkencëtarët nuk besojnë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë, megjithëse theksojnë nevojën për më shumë studime, për të arritur në përfundime të sigurta.

*The World Weather Attribution (WWA)*, një grup shkencëtarësh që gjurmojnë lidhjet mes ngjarjeve të motit ekstrem dhe ndryshimeve klimatike, raportoi se që Italia e veriut të goditet nga tre ciklone brenda një periudhe tre javore kishte mundësi të ndodhte një herë në 200 vjet.

“Kjo do të thotë se në një vit të caktuar, probabiliteti për një ngjarje të tillë është rreth 0.5%,” u raportua. Testet e kryera tregojnë se, në fakt, ndryshimet klimatike e kanë pakësuar probabilitetin e shirave të furishëm në zonat e prekura, nuk e kanë shtuar atë.

Përmbytjet u shkaktuan pjesërisht për shkak të ndërtimeve në mjedis të kryera nga njeriu.

“Në dekadat e fundit, urbanizimi i shpejtë dhe hapësira gjithnjë e më e dendur urbane ka kufizuar hapësirën për drenazhimin natyror dhe ka shtuar rrezikun e përmbytjeve, gjë që ka përshkallëzuar pasojat e shirave të furishëm. Gjithsesi, kjo ishte një ndodhi klimatike jashtëzakonisht e rrallë dhe infrastruktura nuk mund të ndërtohet, brenda asaj që është e arsyeshme, për t’i bërë ballë ngjarjeve kaq të rralla.”

**Konkluzioni:** Ngjarjet e motit ekstrem nuk janë gjithmonë të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Katastrofat e shkaktuara nga moti kanë ndodhur në të gjitha kohërat. Para se të dalësh në konkluzione, fol me ekspertët!

## **Ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale – ku qëndron ndryshimi?**

Ngrohja globale i referohet rritjes afatgjatë të temperaturës mesatare, e shkaktuar kjo nga aktivitetet njerëzore. Që nga fillimi i revolucionit industrial në shekullin e nëntëmbëdhjetë, njerëzit kanë djegur lëndë fosile me një ritëm të paprecedent, duke lëshuar në atmosferë gazra që kanë efektin serë. Kjo ka sjellë ngrohje në shkallë globale. NASA raporton se që nga periodha para-industriale, aktivitetet njerëzore vlerësohet se kanë rritur temperaturën mesatare në botë me rreth një gradë Celsius.

Nga ana tjetër, ndryshimet klimatike kanë të bëjnë me ndryshimet afatgjata në tiparet e motit. Ndërsa ato përfshijnë tendencën e rritjes së temperaturës mesatare, gjithashtu kanë të bëjnë edhe me rritjen e frekuencës së ngjarjeve ekstreme, të tilla si uraganet, valët e të nxehtit dhe përmytjet.

Ajo merret gjithashtu me ndryshimin e tipareve të erës, të tilla si ndryshimi i rrymave të fuqishme të ajrit *Jet Stream* mbi oqeanin Atlantik, të cilat kanë ndikim të thellë në motin që prek Europën.

Disa shkencëtarë besojnë se rryma e ajrit *Jet Stream* do të ndalojë plotësisht këtë shekull, gjë që pritet të sjellë dimra më të ftohtë dhe vera më të nxehta në Europë.

**Konkluzione:** Mos përdor ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike si zëvendësues të njëra-tjetrës, kuptimi i tyre është i ndryshëm. Ndryshimi klimatik nuk ka të bëjë vetëm me verat më të nxehta.

**Sugjerim:** Ka burime të ndryshme mbi ndryshimet klimatike, por një nga më të mirat është Banka Botërore. Këtu ju mund të gjeni të dhëna specifike mbi Shqipërinë përgjatë viteve të ardhshme, përfshirë ndryshimet në reshje dhe numrin e ditëve që me gjasa do të shënojnë temperatura më të larta se 35 gradë. <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/country/albania>

## 6.2 Si të merremi me skeptikët e klimës dhe verifikimi i fakteve

### Mos u jep mohuesve të klimës oksigjen duke u bërë reklamë

Gazetarët shpesh besojnë se, për të provuar “paanësinë” e tyre të shenjtë atyre u duhet të paraqesin në mënyrë të baraspeshuar këndvështrime të kundërta apo konfliktuale.

Shumë nxiten nga ideja që t’u japin zë atyre që nuk kanë zë dhe që t’u kërkojnë llogari establishmentit të fuqishëm.

Rrjedhimisht, duket sikur është kundër kësaj logjike që t’i kërkojë një gazetari të mos i japë peshë një bashkësie të caktuar.

Kur faktet janë të paqarta, natyrisht që është e rëndësishme që reporterët të reflektojnë debatin.

Por në rastet e ndryshimeve klimatike, provat se ato janë të shkaktuara nga njeriu janë kaq të forta, sa zërat e “mohuesve të klimës” nuk duhet të marrin të njëjtën rëndësi dhe duhet të trajtohen me kujdes të madh.

#### 1) Studioji me vëmendje ndryshimet klimatike

Ti nuk duhet të mbështetesh vetëm në këtë manual apo në zërin e një aktivisti apo shkencëtari të vetëm për të të udhëhequr në çështjen e ndryshimeve klimatike, por duhet të kërkojë vetë për informacion të besueshëm.

Një burim i mirë informacioni të tillë është Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe kjo faqe interneti: <https://unccelearn.org/>

#### 2) Kupto dallimin mes aktivizmit, lobizmit dhe gazetarisë

Çdo redaksi lajmesh dhe çdo media ka një numër parimesh që udhëheqin raportimin e saj në kuptim të përzgjedhjes së ngjarjeve për t’u raportuar dhe mënyrës se si këto ngjarje raportohen.

Të gjithë mediat kryesore, për shembull, pranojnë se ndryshimet klimatike janë të vërteta.

Kështu, ndërsa është e pamundur për një gazetar të shkëpusë veten nga disa opinione të caktuara, është gjithashtu e rëndësishme që të qëndrosh, për aq sa është e mundur, jashtë botës së aktivizmit.

Aktivistët mund të jenë një burim i rëndësishëm për të dhënat dhe citimet, por ata duhet të trajtohen me të njëjtin kujdes si çdo bashkëbisedues tjetër. Reporterët duhet të pyesin se çfarë axhende po shtynë ata përpara dhe pse.

### 3) Ki kujdes nga shpëlarja e gjelbër (greenwashing)

Kompanitë që nxjerrin fitime të mëdha në një kohë që kontribuojnë në ndryshimet klimatike kanë interes të fshehtë të nxisin përhapjen e informacioneve të pavërteta dhe të deformuara.

Një industri e tërë ka lindur për të ofruar mundësi për kompanitë që të shpëlahnë me të gjelbër imazhin e tyre përmes një numri skemash, përfshirë kreditet e karbonit.

Gjithmonë bëj pyetje për burimin e informacionit si dhe se çfarë interesi mund të kenë ata në shtyrjen përpara të këtij informacioni.

Dhe mbaj mend, edhe zhvillimet në dukje të gjelbra, kanë anën e tyre negative. Panelet diellore prodhojnë energji të gjelbër, por çfarë bëjmë ne me to në përfundim të afatit të tyre 20 vjeçar të përdorimit?

## 6.3 Si të bësh një lajm mbi ndryshimet klimatike domethënës për audiencën tuaj

Të përfshish audiencën për çështje të ndryshimeve klimatike është një punë sfiduese.

Titujt me paralajmërime për ditën e kiametit apo me paralajmërime për katastrofa globale mund të tërheqin pak vëmendje, por sipas OKB-së dhe Institutit *Thomson Reuters*, kjo përqasje bombastike rrezikon gjithashtu që njerëzit të humbasin interesin.

Në vend të kësaj shpesh është shumë më e vlefshme të përqendrohesh në ndikimin e drejtpërdrejtë që ndryshimet klimatike kanë në jetët e njerëzve, si dhe të tregosh ngjarje nga jeta reale, gjë që shkon përtej klimës.

Këndvështrimi lokal mund të gjendet edhe nëse ndjek zinxhirin e furnizimit nëpër planet.

Shkatërrimi i pyjeve tropikale, diçka që argumentohet se është një nga problemet më të ngutshme mjedisore, lidhet me një mori mënyrash me Shqipërinë.

Për shembull, pulat e konsumuara në të gjithë botën ushqehen me sojë të rritur nga toka të pastruara nga pyjet tropikale, ndërsa lëndët drusore të pemëve të prera në tropik përdoren për mobilie dhe mallra të tjerë.

# SOY AND CONSUMERS

How soy and animal products affect vital ecosystems



**Figura 18:** Ilustrim i [WWF](#) mbi përdorimin e përgjegjshëm të sojës.

Një infografik i prodhuar nga Fondacioni Jeta e Egër (*World Wildlife Foundation*) tregon se si pulat e blera në supermarketin e lagjes mund të lidhen me një zinxhir të gjatë prodhimi me shpyllëzimin.

Shiko aktorët e mëdhenj vendës – fabrikat, restorantet, shitësit me pakicë etj., dhe investigo se nga vijjnë produktet e tyre dhe çfarë lidhjeje mund të kenë ato me krizën klimatike.

Duke kuptuar se si po e prek Shqipërinë ndryshimi i klimës, është e mundur për gazetarët të investigojnë se si mund të preken bashkësi specifike në vend.

Sektorët më të mëdhenj ekonomikë të Shqipërisë janë që të gjithë vulnerabël, ose do të preken nga ndryshimet klimaterike.

## Këtu janë disa pyetje për të ardhmen e Shqipërisë që gazetarët mund të bëjnë:

- Si do të preket sektori i energjisë, i cili mbështetet te hidroenergjinë, nga rënia e nivelit të reshjeve?



- Ndërsa temperaturat rriten, a do të vijojnë turistët të vizitojnë brigjet e Shqipërisë apo do të ndryshojnë në periudha të ndryshme të vitit apo do të zhvendosen në male?
- Sa do të vuajë sektori i bujqësisë i Shqipërisë nga ngjarjet më ekstreme klimatike?
- Si do të preket sektori i vogël i naftës dhe i gazit në Shqipëri, i cili mund të zgjerohet më tutje nëse gjetjet potenciale konfirmohen, nga orientimi i vendit drejt burimeve të energjisë të rinovueshme?

## Shembull: Rritja e nivelit të ujërave

Ndërsa të dhënat klimatike në nivel lokal në Shqipëri nuk janë gjithmonë të disponueshme, ka një numër faqesh interneti ndërkombëtare që ofrojnë të dhëna në nivel lokal.

Një shembull i mirë është [coastal.climatecentral.org](https://coastal.climatecentral.org), që përdor projeksionet më të fundit për nivelin e detit, përfshirë ato të marra së fundmi nga Raporti i Gjashtë i Vlerësimit (AR6 sipas akronimit në anglisht) nga Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike (IPCC), si dhe nga Raporti Teknik mbi Rritjen e Nivelit të Detit për vitin 2022, nga grupi i përbashkët i punës së agjencive të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Nëse shikon hartën e rritjes së nivelit të detit dhe e krahason atë me vitet e shkuara, rezultatet për disa zona të Shqipërisë janë tronditëse.

Le të marrim për shembull Durrësin dhe Vlorën, dy qytete të rëndësishme të Shqipërisë. Sipas hartës aktuale, pjesa më e madhe e qytetit të Durrësit gjendet sakaq poshtë nivelit të përmytjeve vjetore dhe situata do të bëhet më keq. Kjo do të thotë se rreziku i përmytjeve është i lartë që sot.

Situata në Vlorë është me gjasa më shqetësuese. Pjesë të ndryshme të qytetit pritet të bien në kategorinë e zonave të përmytshme brenda vitit 2030.


Kjo nuk do të thotë se këto zona do të përmyten brenda kësaj date, por do të thotë se përmytja bregdetare është një kërcënim serioz dhe se mund të jetë e nevojshme të merren masa për të trajtuar këtë problem.

Minimalisht kjo është një çështje që duhet të bëhet pjesë e një debati serioz vendor mbi masat parandaluese apo lehtësuese për bashkësitë që mund të preken.


Është interesante të eksplorosh atë që po bëjnë autoritetet për të trajtuar këtë problem dhe të flasësh me njerëzit, jetët dhe banesat e së cilëve kërcënohen nga përmytjet.



## Situata aktuale në Vlorë



## Situata në vitin 2030



## Shembuj me raportime që merren me ndikimin e rritjes së temperaturave

Ndërsa temperaturat rriten, jeta në vitet e ardhshme do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.

Dy media ndërkombëtare kanë parë se si do të preken bashkësi të ndryshme nga ndryshimet klimatike dhe rritja e temperaturës.

Propublica së fundmi ka analizuar se ndryshimet klimatike do të prekin komunitetet e varfra krahasimisht më shumë se pjesa tjetër e popullsisë. Zonat me nivel më të lartë varfërie në Kaliforni, kanë tendencën të jenë në mënyrë domethënëse më të nxehta se sa zonat e pasura.

Ky investigim i detajuar tregon se si jeta reale e bashkësive do të preket dhe se si pak kilometra distancë përbëjnë një ndryshim të stërmadh në mënyrën se si njerëzit dëmtohen nga ndryshimet klimatike.

Si do të prekë pjesë të ndryshme të Shqipërisë ndryshimi i klimës dhe si do të preken të varfrit ndryshe nga të pasurit?

Ndërsa Europa parashikohet të goditet nga temperatura deri 50 gradë në të ardhmen, BBC-ja vëzhguar dhe analizuar bashkësi që sakaq po vuajnë temperatura të tilla në një seri raportimesh të titulluara *Jeta në 50°C*.

Si do të përshtaten qytetet në Shqipëri nga valët e pashmangshme të të nxehtit dhe si do të ndryshojë jeta nga kjo në të ardhmen?

#### 7.1 Pamjet ajrore

Pamjet ajrore, pra, pamjet me satelit apo me dron, u ofrojnë reporterëve që raportojnë nga çështjet mjedisore potencial shumë të lartë kërkimor.

Sot, pamjet satelitore janë gjerësisht të disponueshme nga një larmi burimesh falas apo me pagesë në internet, dhe jo vetëm përmes të shumënjohurit Google. Këto pamje janë përdorur me vlerë nga gazetarët që kanë investiguar çështje të tilla si shpyllëzimi, zjarret në pyje, rrjedhjet e naftës, zhvillimet ilegale dhe shumë më tepër se sa kaq.

Shpesh, shumë imazhe përdoren për të treguar ndryshimin me kalimin e kohës, duke përdorur një apo dy fotografi për të dëshmuar diçka që raportimi nga terreni mund të kërkojë shumë muaj për ta arritur.

Reporterët nuk kanë pse të mbështeten më vetëm në pamje satelitore origjinale: një numër filtrash mund të aplikohet mbi foto për të vënë në dukje ndryshimet, duke theksuar vegjetacionin, urbanizimin apo dëmet në pyje nga zjarret dhe këto janë vetëm disa nga mundësitë.

Gjithashtu, kompjuterët mund të përdoren, me ndihmën e koduesve, për të identifikuar objekte të caktuara në sipërfaqe më të mëdha toke, duke hapur shtigje të reja kërkimore për gazetarët.

Në Francë, zyrtarët përdorën inteligjencën artificiale për të identifikuar 20 mijë pishina të ndërtuara në mënyrë të paligjshme duke koduar kompjuterëtn për të njohur karakteristikat specifike të pishinave dhe pastaj duke kërkuar mospërputhjet e terrenit me karakteristikat e përfutuara nga regjistri i planifikimit.

Në Amerikën e Jugut, kërkuesit kanë përdorur foto satelitore dhe inteligjencën artificiale për të numëruar lopët përgjatë kufijve të Amazonës (bagëtia, kryesisht lopët, janë përgjegjëse për 14.5 për qind të emetimeve botërore të gazrave me efekt serë).

Në fund, kur pamjet satelitore nuk janë të disponueshme apo janë të papërballueshme, dronët ofrojnë një Plan B për përdorim në një shkallë më të vogël.

Në këtë kapitull ne do të shohim se si këto teknika janë përdorur nga gazetarët dhe kërkuesit në të gjithë botën dhe se si këto mund të aplikohen në kontekstin e Shqipërisë.

### 7.1.1 Burimet e pamjeve satelitore

Fusha e pamjeve satelitore mund të duket punë e pamundur në plan të parë. Dhjetëra agjenci shtetërore dhe kompani ofrojnë një larmi shërbimesh falas, shërbimesh testuese apo me pagesë. Ky seksion do të rendisë disa nga këto opsione për t'ju ndihmuar ju të orientoheni.

#### ● **Motori i kërkimit Google** ([www.google.com](http://www.google.com))

Vendi më i mirë për të filluar është Google, e cila ka sasi të konsiderueshme imazhesh të disponueshme falas *online*.

Hapi i parë në përdorimin e mjeteve satelitore të Google është që të shkarkosh Google Earth Pro, versioni për desktop. Ky ofron një gamë shumë më të gjerë se sa versioni drejtpërsëdrejti në internet përmes lundruesit (browser). [www.google.com/earth/versions/](http://www.google.com/earth/versions/)

#### ● **Pamje historike**

Një nga tiparet më të vlefshme të Google Earth Pro është aftësia për të parë pas në kohë.

Kjo të lejon ty të shohësh nga ajri ndryshimet madhore në qyteza, pyje, brigje dhe më shumë. Në mënyrë që të lundrosh përmes imazheve historike satelitore, duhet të klikosh "View" në menutë kryesore të mjeteve (*toolbar*) dhe më pas të zgjedhësh kuadratin "historical image".

Ti mund gjithashtu të klikosh ikonën e orës në *toolbar*.

Pasi të bëhet kjo, do të shohësh një kolonë në anën e majtë lartë të ekranit, e cila të lejon të lundrosh përmes imazheve historike.

Nëse gjen diçka interesante, mundesh ta ruash atë imazh duke klikuar "File", pastaj "Save", dhe pastaj, "Save Image".

Është gjithashtu e mundur të kopjosh imazhin duke vajtur te "Edit" tek menutë dhe të shtypësh "copy image". Unë vendosa të shoh se si ka ndryshuar cepi jugor i parkut kryesor të Tiranës përgjatë 20 viteve të fundit. Siç do ta shihni nga këto imazhe, kjo pjesë dikur e qetë dhe e gjelbër e qytetit është transformuar me autostradën e Elbasanit dhe projekte të mëdha ndërtimore.


Ti je gjithashtu në gjendje ta ilustrosh këtë në mënyrë të zgjuar duke i ngarkuar imazhet që ke ruajtur në Juxtapose (<https://juxtapose.knightlab.com/>) – një aplikacion i përgatitur për gazetarët, nga *Knightlab*, një njësi e Universitetit Northwestern në Shtetet e Bashkuara.



Nëpërmjet këtij aplikacioni mund të lëvizësh mes dy pamjeve të mbivendosura, që tregojnë qartë ndryshimet me kalimin e kohës.



**2002-2022**







## Teknologjia “Street View” (Pamjet e rrugëve)

Teknologjia e Google “Street view” është një shërbim që ka më pak përdorime për raportime mjedisore, veçanërisht në Shqipëri, ku pamjet nuk përditësohen me frekuencë të lartë. Por, duke parë zhvillimin e vazhdueshëm të Google, gjithsesi, ia vlen të mësohet kjo teknikë e thjeshtë sepse mund të rezultojë e vlefshme në të ardhmen.

Aktualisht Google Earth Pro nuk ofron të dhëna historike për pamjet nga rrugët kështu që ky shërbim merret vetëm në versionin në internet: [google.com/maps](https://www.google.com/maps).

Nëse i hedh një sy një qyteti si Londra, pamjet e rrugëve kryesore regjistrohen më shumë se sa një herë në vit. Dhe nëse përqendrohemi në kryqëzimin mes Tottenham Court Road dhe Oxford Street, jemi në gjendje të shohim se sa ka ndryshuar ky kryqëzim përgjatë viteve të fundit.



Motori i përpunimit të të dhënave satelitore Sentinel Hub është një burim informacioni jashtëzakonisht i vlefshëm për paraqitje pamore dhe analiza mbi të dhënat satelitore.

Nëpërmjet kësaj platforme të dhëna masive nga satelitët Sentinel dhe Landsat, janë të disponueshme përmes një kërkimi të thjeshtë. Ajo ofron gjithashtu mënyra të ndryshme analizimi të këtyre pamjeve, përmes filtrave specifike, të cilat i lejojnë përdoruesit të shohin ndryshimet më qartë, për shembull, të ndjekin humbjen e bimësisë në një zonë të caktuar.

Kjo faqe interneti menaxhohet nga Ljubjana, Slloveni, nga kompania e teknologjisë së informacionit *Sinergise* dhe megjithëse ka shërbime të ndryshme me pagesë, përdoruesit rastësorë mund të sigurojnë informacion të dobishëm të përfshirë në paketën falas.

Vizito <https://apps.sentinel-hub.com/> dhe regjistrohu për një periudhë prove falas.

### ***Rast studimor: Kontrolli i impaktit të zjarrit në pyje në ishullin e Sazanit në Shqipëri***

Në qershor 2022, një zjarr i madh ra në ishullin e Sazanit në Shqipëri, i cili gjendet pranë qytetit jugor të Vlorës. Ndërsa zjarri u raportua gjerësisht në media, pati shumë pak raportime pas ngjarjes për dëmet që ai la pas. Fakti që ishulli nuk është lehtësisht i arritshëm dhe vizitohet jo rregullisht me varka duket se e shtoi këtë amnezi mediatike.


Në mënyrë që të kontrolloja dëmin e shkaktuar, unë përdora Sentinel hub.

Ja një udhërrëfyes hap pas hapi:

- 1) Hyr në zonën që po kërkon në kutinë e kërkimit dhe afroje imazhin
- 2) Shko te butoni "Discover" në anën e majtë dhe zgjidh cilën bazë të të dhënave satelitore dëshiron të kërkosh. Unë përdora Sentinel 1, i cili kishte pamje mëse të mjaftueshme. Zgjidh afatin kohor: unë po kërkoja për pamje satelitore para dhe pas zjarrit kështu që zgjodha periudhën maj-korrik 2022.
- 3) Kliko butonin "Search" dhe zgjidh opsionet, duke marrë parasysh mbulesën me re, e cila kuptueshëm mund të pengojë pamjen e ishullit.
- 4) Pasi ke gjetur një pamje të qartë para zjarrit, zgjidh "Visualize".
- 5) Pas kësaj të ofrojnë një numër filtrash për të të ndihmuar në kërkim. Në këtë rast unë po kërkoj për humbje të vegjetacionit kështu që zgjodha "false colour", e cila tregon më dukshëm dëmtimin e bimëve.
- 6) Në mënyrë që ta krahasoja këtë me një imazh më të vonë, unë zgjodha kuadratin me shigjetë që drejton në të dyja anët (shih më poshtë). Kjo e ngarkon foton te seksioni "krahaso".



- 7) Pastaj përsërita të njëjtin proces me pamjen nga pas zjarrit.
- 8) Nëse pastaj klikon përmes seksionit "krahaso", atëherë je në gjendje të kalosh nga njëri imazh në tjetrin dhe qartazi të vëshesh ndryshimin dhe dëmin e shkaktuar në ishull nga zjarri.
- 9) Pastaj i shkarkova pamjet duke përdorur butonin në cepin e djathtë poshtë të faqes.



Nga këto foto para dhe pas mund të shohësh shkallën e dëmit të shkaktuar nga zjarri.

## ● Global Forest Watch

Përdorimi i [Global Forest Watch](#) (Roja Botërore e Pyjeve) kërkon shumë më shumë punë të vështirë për të zbuluar shpyllëzimin.

Kjo faqe interneti përdor të dhëna satelitore për të vendosur në hartë ndryshimet në mbulesën pyjore, pikë pas pike, përgjatë njëzet viteve të fundit, duke treguar qartë se ku ka ndodhur shpyllëzimi.


Ndonëse ka kufizime në përdorimin e kësaj përqasjeje, të dhënat padyshim që të mundësojnë të përqendrohesh në fushat kyçe shqetësuese dhe ofrojnë një perspektivë të mirë për tendencat e vendit.

Vendi më i mirë për të filluar është në faqen e hartës: [globalforestwatch.org/map/](https://globalforestwatch.org/map/)

Këtu mund të përqendrohesh në zonën për të cilën interesohesh, për shembull, Shqipërinë.

Është e mundur të luash një animacion që tregon ndryshimet në mbulesën me pyje duke filluar që nga viti 2010. Ajo që ishte e dukshme menjëherë është që shpyllëzimi nuk është i përhapur në mënyrë të njëtrajtshme nëpër të gjithë vendin. Një zonë veçanërisht shqetësuese duket se është Parku Kombëtar i Qafështamës, i cili ka shënuar humbje të sipërfaqeve të mëdha pyjore (të shënuara me rozë) por edhe disa mbjellje të reja, (të shënuara me blu).

Kjo ngre pyetjen se pse janë humbur sipërfaqe të tilla të mëdha në një park kombëtar dhe çfarë pemësh janë mbjellë. Ndonëse pyllëzimi apo ripyllëzimi është me përfitim në parim, mbjellja e pemëve të papërshtatshme mund të ketë ndikim negativ në mjedis dhe nuk zëvendëson larminë biologjike të humbur.



Nëse gjen zonat me pika rozë, do të vësh një vijë thujse vertikale deri mbi Laç, e cila përfaqëson zonat e shpyllëzuara në Parkun Kombëtar të Qafështamës.

## 7.1.2 Inteligjenca artificiale (AI)

Kombinimi i pamjeve satelitore me kompjuterët që mësojnë hap një gamë të re mundësish për reporterët.

Të gjesh manualisht struktura të vogla në morinë e pamjeve nga satelitët është diçka që kërkon shumë kohë. Por falë zhvillimeve në teknologjinë e informacionit, sot është relativisht më e lehtë për koduesit që të programojnë kompjuterët në mënyrë që të identifikojnë tipare të caktuara në pamjet satelitore.

Të tilla mund të jenë pishinat e ndërtuara ilegalisht, shtëpi të djegura nëpër zona konflikti e madje, edhe lopë.

Në Francë, autoritetet arritën të identifikonin 20 mijë pishina të ndërtuara ilegalisht përmes programimit të një kompjuteri për të identifikuar tipare të caktuara dhe pastaj duke i ballafaquar këto tipare të terrenit me regjistrin e planifikimit urban. Këto tipare dalluese, sipas gjasave, ishin forma e rregullt dhe reflektimi i rrezeve të diellit.

Është e kuptueshme që kjo metodë mund të krijojë shumë raste pozitive të pavërteta, të cilat duhet të kontrollohen një nga një manualisht, por kompjuterët të paktën janë në gjendje të reduktojnë në mënyrë drastike, zonat që duhen kontrolluar, duke shkurtuar në këtë mënyrë edhe kohën e nevojshme për gjetjet.

Është e mundur të programosh një kompjuter për të gjurmuar minierat ilegale, shpyllëzimet, ndërtimet pa leje, e madje, edhe plantacionet e kanabisit. Për më shumë, shiko këtu: (<https://insider.govtech.com/california/news/humboldt-using-satellite-tech-against-illicit-cannabis.html>).

Siç në shembullin nga Franca, ka raste kur është e nevojshme që imazhet nga sateliti të ballafaqohen me harta apo baza të tjera të dhënash, të tilla si planet zhvillimore zyrtare të qeverisë, për të identifikuar në këtë mënyrë ndërtimet e dyshuara.

Në mënyrë që të vlerësosh nëse raportimi juaj mund të përfitojë apo jo nga një përqasje e tillë, duhet të marrësh parasysh se cilat janë karakteristikat kyçe të strukturës apo objektit që ti po kërkon dhe nëse këto karakteristika janë përsëritëse.

Karakteristika të tilla mund të jenë përmasat, format, ngjyra, reflektimi, lartësia apo edhe pozicioni në afërsi të një objekti tjetër.

Në Amerikën e Jugut, kërkuesit kanë përdorur pamjet satelitore dhe inteligjencën artificiale për të numëruar lopët në zonat kufitare me Amazonat, (bagëtia, kryesisht lopët, janë përgjegjëse për 14,5 për qind të shkarkimeve globale të gazrave me efekt serë), gjë që sugjeron se edhe objekte të vogla mund të gjurmohen përmes përdorimit të satelitëve.

## Përdorimi i dronëve

Dronët po përdoren për një larmi raportimesh monitoruese të mjedisit nga shkencëtarët dhe aktivistët sot.

Këto përfshijnë monitorimin për ndotjen e ajrit apo ujit, vrojtimin e ndikimit dhe përhapjes së përmytjeve, vrojtimin e shpyllëzimit dhe hetimin e pranisë së mbetjeve plastike.

Ti mund të përdorësh dronin tënd për të mbledhur të dhëna, ndërsa ka edhe kompani private që janë në gjendje të të japin filmime të detajuara.

Dronët janë në gjendje të të ofrojnë fleksibilitet dhe detaje më të mëdha se sa pamjet satelitore. Ju gjithsesi duhet të kontrolloni legjislacionin vendës që rregullon fluturimin e dronëve para se të filloni të filmoni.

## 7.2 Burimet ndërkombëtare të statistikave dhe të të dhënave

Ndonëse të gjesh burime vendore të dhënash është shpesh më e pëlqyeshme, ka disa avantazhe kur këto të dhëna i merr nga burime në nivel ndërkombëtar.

**E para:** Ka raste që të dhënat nuk janë të disponueshme nga një institucion vendës dhe, edhe nëse janë, mund të jenë organizuar në një mënyrë të tillë që është e vështirë t'i vendosësh në mënyrën e duhur për të nxjerrë informacionin që të nevojitet.

**E dyta:** burimet ndërkombëtare të mundësojnë të kuptosh menjëherë se si është situata në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera.

**E treta:** mungesa e statistikave është gjithashtu e dhënë domethënëse dhe mund të jetë një lajm në vetvete. Cila është arsyeja që statistikatat nuk po raportohen?

**Së fundmi:** në lidhje me të dhënat tregtare, të cilat mund të jenë të vlefshme në investigimet e lidhura me mjedisin, duhet të ketë gjithmonë së paku dy burime, eksportuesi dhe importuesi. Kjo do të thotë se ti jo vetëm rrit mundësinë e gjetjes së të dhënave, por do të thotë gjithashtu që ti ke aftësinë të vëresh nëse vendi juaj po fsheh të dhëna të caktuara dëmtuese për imazhin.



## 7.2.1 Statistikat e OKB-së

Divizioni i Statistikave i Kombeve të Bashkuara mbledh të dhëna mjedisore për dhjetë fusha: ajri dhe klima; biodiversiteti; energjia dhe mineralet; pyjet; qeverisja; ujërat e brendshëm; burimet; toka dhe bujqësia; deti dhe zonat bregdetare, katastrofat natyrore dhe mbetjet.

Ne do të shohim disa shembuj se si ju mund të gjeneroni lajme nga këto statistika.

Nëse vizitoni seksionin e lidhur me “popullsinë totale të shërbyer me shërbimin e heqjes së mbeturinave”, do të vëreni se raportimi i Shqipërisë është sporadik dhe se nuk ka të dhëna të ofruara që nga viti 2015.

Data e parë e raportimit të këtyre të dhënave është viti 2003 dhe deri në vitin 2015, përqindja e popullsisë së shërbyer me heqjen e mbeturinave është rritur me vetëm 3 për qind, nga 60 në 63 për qind. Kjo është më e ulët se sa në vendet fqinje të Shqipërisë, ose të paktën krahasuar me vendet fqinje që kanë ofruar të dhëna.

The screenshot shows the UN Stats portal interface. On the left is a navigation menu with categories like Air and Climate, Biodiversity, Energy and Minerals, Forests, Governance, Inland Water Resources, Land and Agriculture, Marine and Coastal Areas, Natural Disasters, and Waste (highlighted). The main content area is titled 'Waste' and lists various indicators with 'XLS' download links, such as 'Composition of municipal waste (latest year)', 'Hazardous waste generated', 'Municipal waste collected', and 'Total waste generated'. On the right, there are links to 'Climate Change Statistics and Indicators Self-Assessment Tool (CISAT)', 'Implementation Guidelines', and 'FDES 2013' (Framework for the Development of Environment Statistics).

Kjo ngre pyetje se pse nuk ka të dhëna më të fundit të ofruara dhe pse Shqipëria po performon më keq se sa fqinjët.

Provoni të eksploroni të dhënat këtu: <https://unstats.un.org/unsd/envstats/qindicators.cshtml>

## 7.2.2 Të dhënat e tregtisë në OKB

Baza e të dhënave të tregtisë që mbahet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Comtrade*, është jashtëzakonisht ndihmuese për gazetarët që kërkojnë të ndjekin lëvizjen e mallrave.

Tregtia ka peshë të madhe në raportimet mbi mjedisin, nga investigimi i lëvizjes së mbetjeve tek

vrojtimi i importit dhe eksportit të lëndëve fosile.

Kjo faqe interneti është relativisht e lehtë në përdorim dhe mund të nxjerrësh goxha shpejt informacion të vlefshëm.

Mallrat ndahen në kode të caktuara, të cilat variojnë nga dy në gjashtë shifra.

Për shembull, kodi 93 përfshin pajimet ushtarake të të gjitha llojeve, kodi 9306 përfshin të gjitha llojet e municioneve ndërsa kodi 930621 është caktuar vetëm për tregtinë e municioneve të shotganëve.

Informacioni raportohet në terma të vlerës monetare të import/eksportit, si dhe shpesh, në terma të peshës. Që të dyja mund të rezultojnë të vlefshme.

Më e rëndësishme, ka dy palë në secilin transaksion import-eksporti kështu që edhe nëse njëra palë nuk ka raportuar lëvizje të mallrave të caktuar, pala tjetër mundet t'i ketë raportuar.

Redaktori i BIRN Albania, Besar Likmeta përdori këtë mjet në mënyrë efikase [kur zbuloi](#) se nga viti 2010 Shqipëria pati vijuar të importonte mbetje, përfshirë disa potencialisht të rrezikshme, pavarësisht se qeveria e kishte ndaluar importimin e mbetjeve.

Kjo u zbulua për shkak se vende të tjera kishin raportuar eksporte mbetjesh drejt Shqipërisë, ndërsa qeveria e Tiranës, jo.

Gjatë investigimit, ai përdori një tabelë të dobishme, të hartuar nga akademikë amerikanë, e cila ofronte udhërrëfyesin mbi të cilin mallrat e kategorive të OKB-së mund të konsiderohen si të rrezikshme. Ju mund ta kontrolloni këtë udhërrëfyes duke vizituar faqen e internetit në vijim:

<https://faculty.georgetown.edu/aml6/pdfs&zips/WasteOfEffort.pdf>

### 7.2.3 Google Scholar

Google Scholar është një mjet i mirë për kërkimin e studimeve akademike që mund të jenë me interes për ju. Pjesa më e madhe e punimeve të detajuara mbi çështje mjedisore kryhet nga akademikë, kështu që ky është një vend shumë i mirë për të filluar kërkimin.

Një kërkim me termat “Albania Wastewater” jep më shumë se sa 10 mijë rezultate. Këto mund të rezultojnë të vlefshëm si në terma të statistikave, ashtu edhe për të sugjeruar se çfarë e si mund të kërkohet.



The screenshot shows the Google Scholar interface with the search term "Albania wastewater". The search results are sorted by relevance. The first result is "The quality of Albanian natural waters and the human impact" by A. Cullaj, A. Hasko, A. Miho, F. Schanz, and H. Brandt, published in 2005 in the journal "Environment". The second result is "Identification and evaluation of water pollution from Albanian tanneries" by T. Floqi, D. Vezir, and I. Malollari, published in 2007 in "Desalination". The third result is "Actual situation of wastewater from food industry and a case study of their treatment" by I. Malollari, L. Pinguli, R. Buzo, V. Lajqi, and S. Makolli, published in 2019 in "J. Environ. Prot.". The fourth result is "Watershed management in the Lake Ohrid region of Albania and Macedonia" by Z. Spirkovski and O. Avramovski, published in 2001 in "Lakes & Reservoirs".

## 7.2.4 Kërkimet e avancuara në Google

Google mbart një sasi të stërmadhe informacioni ndërkombëtar ndihmës, por mund të jetë e vështirë të gjurmosh atë që ke nevojë dhe pastaj të sigurohesh që ajo që ke gjetur është e besueshme. Këto janë disa sugjerime si të përdorësh komandat e avancuara të kërkimit në Google:

### Thonjëzat

Mos harro kurrë të përdorësh thonjëzat përreth togfjalëshit që po kërkon. Nëse, për shembull, po kërkon referenca për ndryshimet klimaterike dhe nuk përfshin thonjëzat ("ndryshime klimatike"), Google do të japë faqe që mbartin fjalën "ndryshime" dhe të tjera që mbartin fjalën "klimatike", por jo doemos togfjalëshin e plotë "ndryshime klimatike".

### Kërkimi i informacionit në faqe specifike

Të gjesh burime të besueshme në Google, biblioteka më e madhe e botës, nuk është gjithnjë një punë e lehtë. Ti do të gjesh sasi të mëdha informacioni, por si mund të jesh i sigurt për burimin?


Për fat, ka një mënyrë për të ngushtuar kërkimin te burime më me reputacion. Shpesh qeveritë janë burim i shkëlqyer informacioni dhe Google të lejon të ngushtosh listën e përzgjedhjes së rezultateve tek disa faqe të caktuara. Shumica e vendeve përdorin fjalën "gov" në adresën e internetit të faqeve të tyre zyrtare.

Shtetet e Bashkuara i kanë faqet zyrtare me: “.gov”, ndërsa Mbretëria e Bashkuar i ka me: “gov.uk”.

Jo të gjitha faqet zyrtare të internetit në Shqipëri ndjekin këtë rregull, por disa, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, e bëjnë. Faqja e saj është: [akm.gov.al](http://akm.gov.al)

Duke kërkuar informacionin që dëshironi, pasuar nga: site:gov në Google, ju do të merrni rezultate vetëm nga faqet e internetit që kanë këtë kod daljeje në internet, pra që mbarojnë me “.gov”.

Ky më poshtë është rezultati i kërkimit për “climate change” (ndryshime klimatike) në listën e faqeve të internetit të qeverisë shqiptare, të cilat përfundojnë me “gov.al”.



Organizatat ndërkombëtare janë gjithashtu një burim i besueshëm informacioni. Faqet e tyre të internetit, përgjithësisht, përdorin prapashitesën “.org” ose “.int”, ndaj këto mund të përdoren për të kufizuar kërkimin.

### Lloji i dokumentit

Në fund, lloji i informacionit që po kërkon ka gjasa të gjendet në një dokument. Ju mund të specifikoni llojin e dokumentit që po kërkon duke i shtuar fjalës apo togfjalëshit të kërkimit: filetype: pasuar nga “.doc” për materiale në Word apo “.pdf” për dokumente PDF e “.xls” për dokumente në formatin Excel.

Në figurë është paraqitur një kërkim në dokumentet PDF në faqet e internetit të qeverisë shqiptare, të cilat përfundojnë me ".gov.al"

Google "climate change" site:gov.al filetype:pdf

Images News Types Effects Solutions Examples Videos Photos Activist All filters Tools SafeSearch

About 546 results (0.45 seconds)

**turizmi.gov.al**  
https://turizmi.gov.al/uploads/2021/10/4-...  
**Albania First National Communication**  
by F Ermira — Albania, for the first time has developed the National Action Plan, which addresses the **climate change** issues as a part of the updated Environmental Action Plan ...

**punetegashtme.gov.al**  
https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/C...  
**Environment and Climate change Dates**  
Agenda for Chapter 27: Environment and **Climate change**. Dates: 13 - 17 May 2019. Venue: Albert Borschette, Rue Froissart 36, 1040 Etterbeek – Meeting Room 1A.  
37 pages

**turizmi.gov.al**  
https://turizmi.gov.al/uploads/2021/10/6-Ko...  
**Third National Communication of the Republic of Albania ...**  
**Climate Change**, i have the honour of presenting the Third national Communication as a serious and determined commitment of the albanian Government to this ...

Organet shtetërore, agjencitë dhe institucionet publike janë përgjegjëse për mbledhjen e shumicës së të dhënave mjedisore. Në disa raste, përgjegjësi të tilla mund të kenë edhe universitetet dhe kompanitë private.

Të dhënat mjedisore mund të jenë në forma të ndryshme: statistika meteorologjike – temperatura, lagështia, ndotja e ajrit, - informacioni mbi cilësinë e ujit - sa i pastër është uji i plazheve apo nëse uji i rubinetit është i pijshëm. Pastaj ka të dhëna mbi tokën, ndotjen, temperaturën për mbjellje, etj., si dhe informacion mbi florën dhe faunën.

Por gazetarët nuk kanë nevojë të mbështeten vetëm tek statistikat dhe të dhënat e ofruara nga autoritetet, universitetet apo organizatat jofitimprurëse për të kryer raportimin e tyre mbi çështjet mjedisore. Në vend të kësaj, reporterët janë në gjendje të mbledhin informacion duke përdorur një gamë metodash nga ato më të thjeshtat teknologjiksht – thjesht duke numëruar – të më komplekset - duke i mbledhur vetë të dhënat, me anë të aparateve tuaj matës.

Kjo e fundit është një fushë e gazetarisë relativisht e re dhe në zhvillim - gazetaria e sensorëve – dhe ofron një mënyrë me kosto të ulët për gazetarët për të ndërtuar aparate të vogla për të grumbulluar të dhëna mjedisore.

Këtu do të shohim se çfarë lloje të dhënash mund të mblidhen dhe si mund të bëhet kjo brenda kushteve etike dhe kufizimeve praktike të gazetarëve, të cilët në këtë rast po hyjnë në një zonë që tradicionalisht i ka takuar shkencëtarëve dhe specialistëve. Gjithashtu, do të diskutojmë nëse gazetarët mund të shfrytëzojnë fuqinë e aparaturave të reja dhe të grumbullojnë të dhëna statistikore më të gjera.

Në kapitujt e mëparshëm ne pamë se çfarë informacioni është i disponueshëm në nivel vendor dhe në nivel ndërkombëtar. Ky kapitull ka të bëjë me mbledhjen e informacionit të dorës së parë nga ti vetë.

Edhe në Shtetet e Bashkuara, ku sasi të stërmëdha të dhënash publike dhe private janë të disponueshme, ka ende nevojë që reporterët të veshin çizmet dhe të dalin në terren. Ne do të shohim disa shembuj të kohëve të fundit të gazetarisë së sensorëve të përdorur në Shtetet e Bashkuara.

Në Shqipëri, sasia e të dhënave të disponueshme përmes kanaleve standarde është më e kufizuar, duke e bërë më të vlefshme idenë që gazetarët të pajisen me sensorë dhe të dalin nga redaksia në terren.

Një argument final në favor të mbledhjes së të dhënave origjinale nga vetë gazetarët është që

kompanitë dhe shtetet shpesh kanë interes t'i manipulojnë të dhënat, ose duke i fshehur ose duke i zbutur, ose thjesht duke gënjer.

Dini ndonjë administratë publike që dëshiron të pranojë se në qytetin përkatës ka nivelin më të lartë të ndotjes në planet? A mos dini ndonjë qendër turistike që dëshiron të informojë udhëtarët se uji i saj nuk është i sigurt për të notuar? Apo nuk kanë tentuar kurrë kompanitë të fshehin pasojat që sjellin llojet e ndryshme të ndotjeve? Përgjigjja për të gjitha këto pyetje është krejt e qartë dhe kjo është arsyeja se pse gazetarët duhet të shohin me dyshim të dhënat zyrtare.

Për rrjedhojë, është e domosdoshme që gazetarët të pyesin veten jo vetëm nëse të dhënat janë të sigurta, por edhe se sa të besueshme janë ato. Kjo, në disa raste, kërkon jo vetëm sy skeptik, por gjithashtu edhe disa njohuri shkencore.

Për shembull, pozicionimi specifik i një monitori për ndotjen e ajrit mund të sjellë matje të cilat nuk reflektojnë gjendjen e zakonshme të ajrit që thithin njerëzit, qoftë kjo për më mirë apo për më keq. Kjo mund të ndodhë për shkak se, fjala vjen, monitori është vendosur pranë një stacioni autobusi, ose është vendosur në mes të një parku të gjelbër.

Në raste të tilla, nevojitet kërkim më i gjerë, gjë që ka gjasa do të përfshijë shqyrtimin e materialeve akademike dhe/ose konsultime me ekspertë të pavarur.

E njëjta gjë vlen edhe për sensorët që reporterët mund t'i ndërtojnë vetë, t' blejnë apo t'i marrin hua. Ju duhet të jeni transparent për llojin e sensorit që po përdorni si dhe ku po e përdorni, ndërsa duhet të konsultoheni me ekspertët e fushës. Publikoni mënyrën e kërimit sepse këto gjëra i shtojnë peshë punës suaj.

Nëse je në gjendje të mbledhësh të dhëna nga disa ose shumë sensorë, kjo është edhe më mirë për shkak se ka gjasa që do të jesh në gjendje të identifikosh probleme në një vendndodhje të caktuar apo me një pajisje të caktuar.

Edhe nëse procesi i mbledhjes së të dhënave është solid, duhet të siguroheni që po e interpretoni informacionin e marrë në mënyrën e duhur.

Si një reporter i ri vendor në Londër, më ngacmoi një raport që, në lidhje me grimcat e pluhurit në ajër, thoshte se një udhëtim 20 minutësh në metronë e Londrës ishte e barabartë me tymosjen e një cigareje. Ndërsa ky konkluzion vinte nga matja e pluhurit në ajrin e metrosë së Londrës, përfundimi se tymosja e një cigareje dhe udhëtimi me metro ishin të barasvlefshëm në terma të dëmit në shëndet ishte dukshëm i gabuar.

Gjithsesi, forca e një "fakti" të tillë është se ai vijon të përsëritet, megjithëse është përgënjeshtruar shumë herë. Kjo është e dëmshme si në drejtim të kuptimit të pasojave reale në shëndet të pluhurit në metro, ashtu edhe të duhanpirjes.

Gazetarët mund të pëlqejnë titujt goditës për t'i dhënë ngjyrë artikujve, por kur bëhet fjalë për

shkencë dhe për çështje shëndetësore, gazetarët duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm.

## Ndotja e ajrit

Monitorimi i ndotjes së ajrit nuk është shumë i përhapur në Shqipëri...

Në Tiranë, kryeqytetin e vendit, nuk ka stacione zyrtare të monitorimit të ndotjes së ajrit dhe, rrjedhimisht, nuk ka as të dhëna, një situatë e jashtëzakonshme për një kryeqytet europian. Kjo ndodh pavarësisht pranisë së njësive shtetërore dhe bashkiake në territor.

Ju mund të gjeni të dhëna nga dy stacione jozyrtare në Tiranë këtu: <https://www.iqair.com/albania/tirana>

Të dhëna mbi stacionet e monitorimit të ajrit në qytete të tjera mund të gjenden në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, por këto të dhëna përjashtojnë Tiranën: [https://akm.gov.al/ova\\_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2021/](https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2021/)

Monitorimi dhe analizimi i ndotjes së ajrit është një detyrë e rëndësishme publike dhe mangësitë në të dhënat nga qeveria janë diçka që mund të mbushet nga gazetarët, në bashkëpunim me universitetet, organizatat dhe ekspertët e pavarur.

## 8.1 Të numërosh dele, ose rrëqebuj

Të numërosh kafshët nuk është një punë revolucionare, por është e rëndësishme, veçanërisht në vendet në të cilat ka pak burime të angazhuara në monitorimin e florës dhe faunës.

Për shembull, Albanian Ornithological Society rregullisht merr pjesë në numërimin për monitorimin e pranisë së zogjve shtegtarë në Shqipëri (<https://aos-alb.org>).

Përgjatë viteve, përmes numërimit, është e mundur të shohësh tendencën, nëse popullata e llojeve të caktuara po rritet apo po pakësohet.

Një gazetar apo një individ i vetëm ka pak gjasa të jetë në gjendje të bëjë diçka vetëm, por përmes fuqisë së burimeve në grup (*crowd-sourcing*), reporterët janë në gjendje të mobilizojnë një ushtri vullnetarësh. Nëse ke dhjetëra apo qindra pika të grumbullimit të të dhënave mbi praninë e kafshëve apo bimëve të caktuara, atëherë fillon të dallos tendencën.

Një mjet tjetër që tashmë përdoret gjerësisht nga organizatat dhe mund të merret edhe nga gazetarët, është kamera kurth. Këto mjete lehtësisht të përdorshme mund të blihen për disa



qindra euro dhe të përdoren përgjatë shumë viteve.

Për shembull, organizata “Mbrotja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri” ka dokumentuar praninë e rrëqebullit të Ballkanit në malet e Shqipërisë, falë këtyre kamerave. Kjo kafshë është e kërcënuar për zhdukje në mënyrë kritike. Një nga pamjet më të fundit u shënua në vitin 2021:



**Figura 19:** Fotografi e Lynx lynx balcanicus e shkrepur nga monitorimet e [PPNEA / BLRP](#).

Çfarë tjetër nga flora dhe fauna duhet të gjurmojnë gazetarët?

Media ka shumë për të mësuar nga puna e sektorit të organizatave jofitimprurëse.

## 8.2 Bli ose merr me qira pajisje



Reporterët ka pak gjasa të kenë një arsenal me pajisje të kushtueshme monitorimi në dispozicion.

Por nëse redaksia e tyre nuk ka mundësi të përballojë blerje për një investigim specifik, mund të jetë e mundshme të marrësh hua, të marrësh me qira apo të bëhesh skuadër me një institucion tjetër.

Reporterët investigativë të *USA Today* ishin në gjendje të merrnin me qira një pajisje shumë të kushtueshme në përpjekjen e tyre për të testuar përbërjen kimike të tokës përreth fabrikave të mbyllura.

Reporterët vendosën t'i hynin këtij investigimi pasi lexuan një raport që identifikonte më shumë se 400 zona industriale, të cilat nuk ishin kontrolluar siç duhet për ndotje.

Pajisja *X-Ray Fluorescence Analyzer* kushton 41 mijë dollarë, por reporterët ishin në gjendje të negocionin marrjen e saj me qira për \$2.250 në muaj.

Megjithëse i kushtueshëm, procesi mbledhi të dhëna shumë më të çmuara, duke zbuluar se shumë nga zonat e identifikuara kishin nivel plumbi shumë më të lartë se sa limiti i konsideruar i parrezikshëm.

Impakti ka qenë i gjerë dhe autoritetet filluan të investigojnë gjetjet dhe të marrin masa për zonat e identifikuara.

Duke folur për faqen e internetit *Nieman Reports*, pjesë e shkollës së gazetarisë së Harvardit, një nga reporteret kryesore, Alizon Jang, tha se ajo kishte punuar shumë për të mësuar mbi metodat shkencore, se si funksiononte teknologjia, si dhe kishte konsultuar ekspertë dhe kishte kryer analiza shtesë të kampioneve të tokës për të konfirmuar gjetjet e dala nga monitorimi.

Si një reporter i ri në Londër, binda një akademik që të më huazonte një instrument që mat

pjesëzat e pluhurit në metronë e Londrës.

Kalova një ditë duke udhëtuar lartë e poshtë linjës së veriut, duke grumbulluar informacion mbi ajrin që thithin miliona njerëz çdo vit.

Të dhënat ishin shqetësuese – niveli i pluhurit ishte shumë i lartë – por se çfarë do të thoshte kjo për shëndetin e njerëzve nuk ishte kaq e lehtë të kuptohej dhe u konsultova me ekspertë në mënyrë që të raportoja ndershmërisht dhe pa ekzagjerime.

Reporterët duhet të kenë kujdes për mënyrën se si i përdorin të dhënat e mbledhura dhe duhet të jenë të përgjegjshëm e të konsultohen me ekspertët kur ka nevojë për interpretim të duhur të të dhënave.

Ka zona industriale, si aktuale ashtu edhe historike në Shqipëri, ku gazetarët dhe shkencëtarët mund të punojnë bashkë dhe mund të kryejnë investigime të rëndësishme mbi ndotjen e trashëguar.

### 8.3 Gazetaria e sensorëve



**Figura 20:** Një foto nga faqja e internetit e Arduino, një prodhues italian pajisjesh elektronike

Gazetaria e sensorëve është një zhvillim relativisht i ri dhe është krijuar nga rënia e çmimeve të sensorëve për vetëpërdorim.

Këto projekte kërkojnë një nivel të kuptuari bazë të kodimit dhe njohuri se si mund të ndërtohen pajisje të thjeshta elektronike. Kjo është brenda asaj që mund të arrihet nga reporterët me aftësi praktike, të cilët po kërkojnë të zhvillojnë aftësi të reja.

Për reporterët që nuk u vjen për dore kjo, është e lehtë të gjejnë ndihmë nga kodues miqësorë apo entuziastë të elektronikës.

Të ndërtosh një sensor sipas nevojës:

- 1) Një bord – d.m.th., një mini kompjuter – i cili mund të programohet për të kryer disa funksione bazë
- 2) Një burim energjie, i cili mund të jetë një bateri ose një minipanel diellor
- 3) Sensorë për të mbledhur të dhëna – të tillë si termometër apo matës i turbullirës së ujit
- 4) Ka raste që për të ruajtur të dhënat e mbledhura, nevojitet një lloj microSDcard ose ndoshta një sistem *cloud* nëse bordi është i lidhur me wifi apo me një kartë SIM telefoni celular.

Arduino është një markë e njohur e bordeve elektronike që përdoren nga gazetarët. Ka edhe një komunitet aktiv që ndan kodet dhe informacionin se si bëhet.

Kjo mënyrë testimi “bëje vetë” është përdorur gjerësisht dhe me rezultate të mira gjatë viteve të fundit, më së shumti në SHBA. Më poshtë po japimdisa shembuj praktikë:

- 1) Cila është temperatura reale me të cilën përballen banorët e Harlemit në Nju Jork? Ndërsa qytetet si Tirana vera po bëhet gjithnjë e më e nxehtë, ky lloj eksperimenti mund të ofrojë të dhëna interesante mbi pasojat që vuajnë ata që jetojnë në qendrat e qyteteve.
- 2) Pushtimi nga buburrecët. Pjesë të mëdha të Amerikës veriore dhe lindore pushtohen nga gjinkallat një herë në çdo shtatëmbëdhjetë vjet. Të armatosur me njohurinë që gjinkallat i chelin vezët vetëm pasi toka arrin një temperaturë të caktuar, ata rekrutuan qindra njerëz për të instaluar termometra në tokë me qëllim që të parashikonin mbërritjen e tyre.
- 3) Arduino ka krijuar pajisjen e vet me sensorë për matjen e cilësisë së ujit. Informacion më i detajuar mund të gjendet në adresën e mëposhtme: <https://blog.arduino.cc/2023/03/23/this-sensor-determines-if-water-is-good-for-drinking/> Cilët lumenj apo plazhe në Shqipëri mund të analizohen me pajisje të tilla?

Sensorët mund të na ndihmojnë për matjen e nivelit të ujërave, cilësinë e ajrit, rrezatimin e shumë të tjera. Me më pak se 100 euro dhe me pak njohuri teknike, ti mund të ndërtosh sensorin tënd.



Të kuptosh ndikimin që bizneset kanë në mjedis është pjesë kyçe në punën e një reporteri.

Megjithëse natyrisht që ka shumë kompani që i binden ligjit dhe që janë të gatshëm të bëjnë pjesën që u takon në të mirë të njerëzimit, kompanitë, për nga natyra, kanë interes parësor fitimet.

Në shumicën e rasteve, shkarkimi i mbetjeve dhe trajtimi i ndotjes, si në ajër, në tokë apo në ujë, nëse bëhet siç duhet, sjell ulje të fitimeve dhe kjo i nxit shumë prej tyre që t'i bien shkurt.

Kjo është veçanërisht e vërtetë për vendet me zbatim të dobët të ligjit dhe korrupsion të lartë.

Gjithsesi, ka një presion në rritje mbi qeveritë që të licencojnë dhe inspektojnë siç duhet bizneset e përfshira në fusha të caktuara dhe të imponojnë vlerësime të ndikimit në mjedis mbi zhvillimin e pronave dhe infrastrukturës.

Kompanitë e mëdha janë gjithashtu të angazhuara në përpjekje kombëtare apo ndërkombëtare për të provuar kredencialet e tyre të gjelbra, pretendimet për neutralitet karboni e të tilla, të cilat shpesh mbështeten nga praktika të dyshimta për sa i përket vlerës reale në mbrojtjen e mjedisit.

Ne do të shohim disa nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare dhe se si reporterët mund të mbajnë përgjegjëse kompanitë.

#### Bujqësia

Sa i përhapur është përdorimi i pesticideve të ndaluara në BE në Shqipëri?

Përdorimi i pesticideve toksike, të cilat janë ndaluar prej kohësh në BE, mbetet një problem në Ballkan.

Një studim i kohëve të fundit në Liqenin e Shkodrës nga *The Center for Ecotoxicological Research* (CETI) në Podgoricë, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe organizatën *Green Center of Albania* në Shkodër, gjeti gjurmë pesticidesh të cilat janë të ndaluara në ujërat e BE-së.

[Balkan Insight](#) së fundmi raportoi se pesticidet e ndaluara përdoren gjerësisht në Malin e Zi. Fermerët në vështirësi janë të prirur t'i përdorin ato pasi ato shpesh janë më të forta se alternativat e ligjshme.

## Peshkimi

Peshkimi është një aktivitet i licencuar në Shqipëri me gati 800 varka të licencuara.

Detet e Shqipërisë, njësoj si pjesa tjetër e Mesdheut, kanë vuajtur nga mbipeshkimi dhe dëmtimi i shtratit të detit përmes metodave të papërshtatshme të peshkimit.

Kjo përfshin vjeljen dhe shitjen e midhjeve shkëmbshpuese (*dateri*), aktivitete të ndaluara ligjërisht për shkak të dëmeve mjedisore në shtratin e detit. Megjithatë, këto midhje shiten gjerësisht në treg.

Peshku ton është shumë i chmuar dhe i nënshtrohet kuotave ndërkombëtare të peshkimit. Kjo krijon një shtysë të fortë për mashtrime dhe aktivitete të paligjshme, siç është dokumentuar nga ICJ në serinë e investigimeve të tyre të vitit 2012: *Grabitja e deteve*: (<https://www.icij.org/investigations/looting-the-seas/part-i-mediterranean-feeding-frenzy/>)

Edhe peshkimi jashtë zonave të lejuara është një aktivitet që ka një shtysë të fortë në interes të fitimeve. Së paku, një anije shqiptare është kapur duke peshkuar në ujërat territoriale të Maltës për ton në vitet e fundit. Anijet e huaja janë kapur gjithashtu duke peshkuar ilegalisht në ujërat shqiptare.

Tashmë anijet e mëdha janë të pajisura me sisteme të monitorimit satelitor. Shumë nga këto anije të mëdha mund të gjurmohen përmes shërbimeve tregtare të tilla si *Marine Traffic*.

### Çfarë dokumentesh mbajnë zyrtarët mbi peshkimin?

Këtu janë paraqitur disa prej dokumenteve që mund të ndiqen dhe të jenë të vlefshme në raportimmbi industria e peshkimit:

- Lista e anijeve të peshkimit. Me këtë ju mund të shikoni kush e kontrollon peshkimin në Shqipëri dhe cilat janë kuotat e tyre.
  - Cilat anije janë inspektuar dhe dënuar.
- A ka lloje të rrezikuara peshqish apo molusqesh në treg?
- Gjurmimi i flotave të mëdha të peshkimit të Shqipërisë në [Marinetraffic.com](https://www.marinetraffic.com)



## Vlerësimi i ndikimit në mjedis

Shumë projekte të mëdha, nga zhvillimet urbane te ndërtimi i rrugëve, kërkojnë vlerësim të ndikimit në mjedis. Këto raporte, të hartuara nga ekspertë mjedisorë të pavarur, vlerësojnë dëmin potencial dhe masat që duhet të ndërmerren gjatë planifikimit dhe zbatimit të një projekti për shmangien e dëmeve mjedisore.

Ndërsa, në disa raste, këto raporte janë kritikuar si mjete që zhvilluesit i përdorin për të nxjerrë të lara projektet e tyre, ato mund të ofrojnë gjithashtu informacione të rëndësishme.

Për shembull, një investigim nga Beogradi, Serbi, përdori një vlerësim të ndikimit në mjedis, i cili nuk ishte publikuar për të zbuluar detaje të reja mbi ndikimin e një projekti të propozuar për një minierë të re litiumi.

Sipas investigimit, u raportua: “Një vlerësim i ndikimit në mjedis i papublikuar nga Rio Tinto tregon se mund të humbasin vlera të biodiversitetit dhe ndotja e ajrit nga grimcat toksike mund të shkaktojë rrezik në shkallë të gjerë për shëndetin e popullsisë.”

Në [Bosnjë](#), një raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i hartuar në lidhje me seksione të reja të një venddepozitimi të mbetjeve zbuloi detaje shqetësuese.

“Studimi tregoi se rrjedhjet kishin përqendrimet të larta të substancave që ishin përtej nivelit të lejuar të rregulloreve. Ai del në përfundimin se operacionet aktuale dhe infrastruktura ekzistuese nuk garantojnë dot menaxhimin e sigurt të mbetjeve pa rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Që të jetë e sigurt për mjedisin, PE “Deponija” duhet të ketë një impiant trajtimi dhe për shkak se një impiant i tillë nuk ekziston, sipërmarrja nuk disponon lejet e nevojshme.”

Edhe mungesa e një raporti mjedisor në vetvete apo mungesa e mbulimit të të gjitha problemeve, është domethënëse.

Për shembull, [Rumania](#) u hetua nga Komisioni Europian për shkak se nuk kishte raportuar humbjen e 700 hektarëve me pyje në një raport vlerësimi të ndikimit në mjedis mbi zgjerimin e një miniere.

Ndërtimi i një termocentrali të ri në Serbi është vonuar pasi u zbulua se ndikimi i vlerësimit në mjedis nuk përfshinte konsultimin e Rumanisë fqinje, e cila mund të prekej nga planet.

### **Sugjerim:** Raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Kontrollo raportin para projektit dhe shiko nëse ndikimi në jetën reale është ai çfarë raporti ka pretenduar fillimisht.

Raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë të disponueshme në faqen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë: ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al))

## Regjistri i Çlirimeve dhe Transferimeve të Ndotësve

Regjistri i Çlirimeve dhe Transferimeve të Ndotësve (PRTR sipas akronimit në anglisht) është një bazë të dhënash e aksesueshme publikisht e kimikateve apo ndotësve të çliruar në ajër, ujë apo tokë dhe të transferuara jashtë për trajtim, sipas përkufizimit të OECD-së. Ky regjistër përmbledh informacionin mbi kimikatet që çlirohen në natyrë, ku, si dhe në çfarë sasive, si dhe nga kush.

Ky duhet të jetë një mjet kyç për reporterët dhe publikun për të gjurmuar problemet mjedisore, por, deri më sot, nuk ka informacion të disponueshëm publik në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, megjithëse një seksion për këtë qëllim është krijuar.

## Industria e naftës

Problemet me ndotjen nga industria e naftës në Shqipëri janë raportuar rregullisht.

Por nëse marrim parasysh moshën e puseve dhe të infrastrukturës dhe mundësinë për zgjerim të mëtejshëm, problemet e lidhura me ndikimin në mjedis të kësaj industrie ka gjasa do të vijojnë.

Një raport i kohëve të fundit nga Komisioni Shqiptar i Helsinkit gjeti nivele shqetësuese ndotjeje duke u mbështetur gjerësisht në dokumente të siguruara përmes përdorimit të kërkesave për të drejtën e informimit.

Ata morën nga autoritetet vendore dhe degët rajonale të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një numër raportesh inspektimi, si dhe vendime zyrtare për gjoba ndaj firmave të naftës.

Dokumentet ofruan informacion dhe të dhëna të çmuara mbi gjendjen e ndotjes në zonë dhe mbi shumë tema të tjera të vlefshme potencialisht për investigime të mëtejshme.

## Sugjerime

Gjeni se çfarë dokumentesh zyrtare krijohen nga institucionet publike dhe si quhen ato.

Kërkoni se kush i shkruan këto raporte dhe me kë ndahen ato.

Përdor këtë informacion për të dërguar kërkesa për të drejta informimi mbi dokumente zyrtare, përfshirë edhe ato që gjenden apo prodhohen në institucionet vendore.

## Shpëlarja e gjelbër

Kompanitë e mëdha gjithnjë e më shumë po përpiqen të paraqiten si kompani miqësore ndaj mjedisit.

Kjo shpesh nënkupton blerjen e krediteve të karbonit si kompensim, në vend të reduktimit të ndikimit që ato vetë kanë në mjedis. Në praktikë, kjo i lejon kompanitë të shkëmbejnë shkarkimet e veta të karbonit me aktivitete që ndihmojnë kapjen e karbonit, të tilla si mbjellja e pemëve.

Gjithsesi, një seri investigimesh kanë ngritur pikëpyetje mbi vlerën reale të këtyre krediteve të karbonit.


Një [investigim i The Guardian](#) të Londrës më 2023, zbuloi se 90 për qind e krediteve të ofruara nga një nga ofruesit e mëdhenj ishin të pavlera në lidhje me ndikimin që kishin në shkarkimet e karbonit.

Një [investigim i ICIJ](#) zbuloi se si kompanitë e mëdha që janë certifikuar si miqësore me mjedisin shpesh janë larg nga të qenit të tilla.

Ndërsa kjo çështje nuk është ende shqetësim madhor për kompanitë shqiptare, investitorët e huaj të mëdhenj në Shqipëri, të tillë si Shell, mund të kërkojnë të sigurojnë kredite të karbonit, si kompensim të shkarkimeve të tyre të karbonit, ndërsa kërkesa e kompanive vendëse për skema të tilla me gjasa do të rritet. Për rrjedhojë, kjo është një fushë në të cilën reporterët shqiptarë duhet të mbajnë një sy hapur në të ardhmen.



**MANUAL PËR GAZETARË:  
RAPORTIMI MBI MJEDISIN  
DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE  
NË SHQIPËRI**



© Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri - Balkan  
Investigative Reporting Network Albania (BIRN Albania)  
Tiranë, 2023